

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit Master i shkencave në: “Inxhinieri Elektronike”

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA



Tetor / 2018


RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Msc në “Inxhinieri Elektronike”

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr.411, datë 25.08.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VBA Nr. 36, date 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Master i shkencave në “Inxhinieri Elektronike”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve për programin e studimit	55

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc. në "Inxhinieri Elektronike" në Universitetin Privat "Albanian University"

Albanian University fillimisht është hapur si shkollë e lartë universitare jopublike "Ufo Dental" me VKM nr.197, datë 10.04.2004. Me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009. Emërtimi dhe emri i shkollës së lartë universitare, private "UFO dental", ndryshon në Universiteti privat "Ufo University dhe me VKM Nr. 603, datë 24.8.2011 ndryshon emërtimi nga "UFO University" në Universiteti Privat "Albanian University".

Programi i studimit MSc në "Inxhinieri Elektronike", është licensuar me urdhër Nr.411, datë 25.08.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Në Maj 2017 ky program studimi kaloi akreditimin e parë me kohëzgjatjen prej 1 vit akademik, me afat përfundimi të vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit deri më 31.07.2018

Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike zhvillohet në Universitetin Privat "Albanian University", përkatësisht në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, në Departamentin e Inxhinierisë.

Në bazë të vendimit të Senatit Akademik të këtij Institucioni Nr. 1823 datë 10.10.2014 bëhet edhe ndryshimi i emërimit të fakultetit në "Fakultet të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike". Në bazë të Vendimit Nr. 1823/5 date 10.10.2014 [dok.51] bëhet edhe ndryshimi i emërimit të Departamentit ku zhvillohet ky program studimi në "Departamentin e Inxhinierive".

Bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit (VBA) nr. 36 datë 19.05.2017, janë gjetur disa konstatime të cilat paraqesin nevojën për përmirësimin nga ana e Institucionit "Albanian University" [dok. 121 – Vendimin e Bordit të Akreditimit date 19.05.2017]

Gjatë periudhës Prill 2018 ky program studimi u rishikua nga ana e Departamentit të Inxhinierive në Universitetin Privat "Albanian University" në përputhje me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Në datë 20.08.2018 ky Institucion paraqet pranë ASCAL me shkresë me nr. 248 Prot. Raportin e Vlerësimit të Brendshëm për Programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike (i hartuar në gjuhë shqipe dhe anglisht) dhe subjekt i këtij raport vlerësimi të kryer nga ana e grupit tonë të vlerësimit të jashtëm.

Puna e Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Në lidhje me vlerësimin e këtij programi dhe vlerësimin e punës së bërë nga ky institucion për përbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i përbërë nga Prof. Dr. Thoma Korini dhe Dr. Alketa Grepcka të kontraktuar nga Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ndërmorri një punë serioze që në mënyrë të përmbledhur konsiston si më poshtë:

1. Njohje me rekomandimet të dhëna nga Bordi i Akreditimit;
2. Njohje me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të hartuar nga IAL "Albanian University";
3. Vizitë dy ditore (19-20.09.2018) në Institucion sipas një axhende të hartuar dhe të miratuar edhe nga vete institucioni "Albanian University" e cila konsistonte në takime me grupet si vijon:
 - a. Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit/koordinatorët e programeve të studimit;
 - b. Takim me Grupin e vetëvlerësimit për programin Msc në "Inxhinieri Elektronike";
 - c. Takim me stafin akademik të programit të studimit Msc në "Inxhinieri Elektronike";
 - d. Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
 - e. Vizitë në sekretarinë mësimore;
 - f. Takim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, dhe Zyrën e Karrierës dhe Koordinimit Mbështetës ndaj Studentit;
 - g. Takim në Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave;
 - h. Takim me studentët e Msc në "Inxhinieri Elektronike";
 - i. Takim në Zyrën e koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike;
 - j. Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.), vizitë në Bibliotekë;
 - k. Takim në Zyrën e Burimeve Njerëzore

Në raport GVJ jep mendimin e tij të pavaruar për shkallën e plotësimit të standarteve akademike për këtë program studimi (PS). Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), në dokumentacionin bazë mbi të cilin kryen veprimtarinë Universiteti Privat "Albanian University", në dosjen e plotë të programit të studimit në fjalë, në takimet e zhvilluara si dhe në materialet e ndryshme që u vunë në dispozicion

Vlerësimi i programit të studimit u përqëndrua në analizën e programit të studimit bazuar në shqyrtimin e programeve të lëndëve, metodave të mësimdhënies, në literaturën bazë dhe atë shtesë, në mënyrat e vlerësimit të dijeve të studenteve, në përcaktimin e krediteve dhe ndarjen e tyre brenda lëndës si dhe në kompetencat e stafit akademik. GVJ e bëri vlerësimin mbi bazën e plotësimit të gjithë kritereve të standartave shtetërore të cilësisë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Prof. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA

GVJ është asistuar gjatë gjithë procedurës nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli

Universiteti Privat "Albanian University" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 22.10.2018, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 7/26 Prot, datë 22.10.2018. AU përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 305 Prot, datë 22.10.2018 përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjet kësaj shkrese Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit

Bordi i Akreditimit përmes Vendimit të tij nr. 36 datë 19.05.2017, ndonësë sic theksohet edhe nga RVB e përgatitur nga Institucioni nuk ka shprehur rekomandime, evidenton disa konstatime sic vijon më poshtë që u konsideruan edhe nga ana GVJ në punën e tij për hartimin e këtij raporti:

Ndër konstatimet që mbështesin këtë vlerësim përmenden:

1. Ngarkesa mësimore e stafit akademik është e lartë pasi angazhohen në disa lëndë në program të ndryshme;
2. Pedagogët e jashtëm nuk zotërojnë leje individuale nga institucioni ku janë të punësuar më kohë të plotë, sikurse kërkohet nga Ligji 80/2015,

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Për konstatimin 1, Ngarkesa mësimore e stafit akademik është e lartë pasi angazhohen në disa lëndë në program të ndryshme institucioni i ka përmbushur kryesisht :

Në lidhje me përmbushjen e këtij konstatimi nga ana e Bordit të Akreditimit, kemi evidentuar përpjekje të Institucionit dhe të Departamentit të Inxhinierive.

Për vitin akademik 2017 – 2018 janë punësuar dy pedagogë me gradën shkencore Doktor ndonësë kërkesa për rekrutim të stafit në këtë departament është i madh. Ngarkesa mësimore e stafit akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinier Elektronike është në përputhje me

standartet por në tëresinë e tij konstatojmë që ngarkesa totale që ky staf jep edhe në programet Bachelor është i madh. Ndonëse nuk kemi evidenca të qarta në lidhje me impaktin që kjo mbingarkësë ndikon në cilësinë e mësimdhënies e konsiderojmë si një faktor që duhet të merret në shqyrtim. Synimi që departamenti i Inxhinierive ka në hapjen e dy programe të reja Master Profesional në Sisteme të Energjisë dhe Master profesional në Inxhinieria e Inteligjencës së Biznesit e bën akoma edhe më të rëndësishme plotësimin e nevojave të tij me staf akademik.

Për konstatimin 2, Pedagogët e jashtën nuk zotërojnë leje individuale nga institucioni ku janë të punësuar më kohë të plotë, sikurse kërkohet nga Ligji 80/2015, institucioni i ka përmbushur plotësisht

Vizita në Institucion dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore vërtetoi që stafi akademik i angazhuar më kohë të pjesshme është i pajisur më lejet përkatëse nga institucioni ku punon. Institucioni ka ndërmarrë gjithë hapat e nevojshëm dhe personeli akademik i ftuar zotëron leje individuale nga Institucioni ku është punësuar me kohë të plotë në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.

Konkluzion: Konkludojmë që konstatimet e Bordit të Akreditimit janë konsideruar nga ana e Departamentit të Inxhinierive. Përpjekjet për plotësimin e tyre janë shumë pozitive ndonëse akoma ka shumë punë për tu bërë në lidhje me plotësimin e nevojave që programet e studimit paraqesin për staf akademik.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike ofrohet në përputhje me misionin, strategjinë e zhvillimit institucional të Universitetit [dok 67- Statuti i AU, neni 2].

Në misionin e saj AU synon që:

- Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;
- Të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;
- Të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatise specialistë dhe shkencëtarë të rinj;
- Të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese;
- Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimit i lartë gjatë gjithë jetës;
- Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Të kontribuojë në rritjen e standardeve të dekomakracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore;
- Të ofrojë shërbimë, në përputhje me misionin e tij;
- Të mbështesë dhe realizojë afësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkimin shkencor;

Objektivat e përgjithshme janë të shprehur në Rregulloren e Programit të Studimit MSc. Inxhinieri Elektronike [dok. 13-Neni 4]. Objektivat e AU janë të shprehur edhe në Strategjinë e Zhvillimit 2017-2022 [dok.21 fq.4]. Këto objektiva përqëndrohen në drejtimet e mëposhtme:

1. Objektivat e Organizimit Institucional;
2. Mësimdhënia, kurrikulat dhe mësimnxënia me qëndër formimin e studentëve;
3. Kërkimin Shkencor dhe Invacionin;
4. Veprimtaritë shërbyese;

5. Marrëdhëniet me jashtë;

Objektivat e Përgjithshme të Programit të Studimit të MSc. **Inxhinieri Elektronikë** ofrohen në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit si dhe strategjinë për zhvillim të tij. Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, me zhvillimin ekonomik të vendit. [dok. 13-Neni 4]

Nër objektivat kryesore vlen të përmenden:

1. Ofrimi i njohurive më të nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara shkencore dhe profesionale në fushën e Inxhinierisë Elektronike përmes metodave, instrumenteve dhe teknikave inovative.
2. Përvetësimi i këtyre aftësive në sajë të thellimit të njohurive, që studentët marrin në programet *Bachelor* në fushën e Inxhinierisë. Thellimi i këtyre njohurimve në programin *Master i Shkencave* përmes zbatimit të një plani metodologjik dhe aplikativ, në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të përballuar problematikat e ndryshme të fushës së studimit, projektimin dhe zhvillimin e impianteve dhe sistemeve elektronike, si dhe për të dhënë kontributin përkatës në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të këtij sektori.
3. Formimi teoriko-praktik përmes integrit të shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës.
4. Thellimi i njohurive të studentëve në drejtimin e kërkimit shkencor dhe krijimi një baze të qëndrueshme njohurish për të vazhduar më pas studimet e ciklit të tretë - doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.
5. Mbështetja në përvojën disavjeçare dhe praktikat më të mira të vendeve europiane.
6. Të qenurit konkurrues për nga elementët që përmban (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri.

Objektiva specifike të Programit të Studimit MSc. Inxhinieri Elektronikë [dok. 13]:

Të diplomuarit në kuadër të këtij programi studimi do të marrin njohuri teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre:

- a. Për të zhvilluar veprimtarinë në institucione publike dhe private në kuadër të sistemeve elektronike të aplikuara dhe në telekomunikacion;
- b. Për të zhvilluar veprimtarinë në mënyrë të drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektronike, si dhe projektimin dhe realizimin e sistemeve të telekomunikacionit;
- c. Pas një periudhe praktike në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar kualifikimin edhe përgatitjen e teknikëve dhe profesionistëve të ardhshëm në këtë fushë.

Për plotësimin e tyre Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka ndërtuar edhe Strategjinë 2017-2018 [dok.58] ky synimi kryesor është:

1. Hapja e programeve të reja studimi në përputhje me nevojat e tregut konkretisht në programet ~~Master Profesional në Sisteme të Energjisë, Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike.~~
2. Kualifikimi i mëtjshëm i të diplomuarve përmes zhvillimit të kurseve mbi standardet ndërkombëtare dhe europiane mbi sisteme të ndryshme menaxhimi.
3. Mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ duke rritur aplikimet në Erasmus+ 2018 me Universitetin e Camerinos, në programin *Tëinning*,
4. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit përmes zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimeve me Universitete partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Zgjerimi i marrëveshjeve me biznese vendase në kuadër të praktikave mësimore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronikë ka të përcaktuar qartë misionin, objektivat e saj. Synimi kryesor është përgatitja teorike – praktike përmes thellimit të njohurive të marra në Bachelor dhe përmes zbatimit të praktikave më të mira në mësimdhënië [dok.4]. Ky program studimi përpiqet të jetë konkurrues dhe aftësimi i studentëve në fund të studimeve të tyre të përgjigjet kërkesave të tregut të punës. Ndërtimi i programit dhe politika përmiresuese e tij (në mënyrë të vazhdueshme) janë të bazuara në një studim të qartë të tregut të punës [dok.46 – Studimi i tregut të punës]. Evidencat përmirësime në lidhje me përthithjen e mendimit të kompanive të biznesit. Për vitin 2017 departamenti i inxhinierive ka kryer studim të tregut përmes marrjes së informacionit nga INSTAT për kategoritë inxhinierike si edhe përmes pyetsorëve tek studentët (17 studentë të fushës elektronikë) dhe kompanitë e biznesit (33) me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale. Institucioni përmes këtij program studimi kontribuon në zhvillimin e vendit në veçanti dhe atë rajonal e më gjerë nëpërmjet konsolidimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të tij [dok.41 – Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional]. Ky program studimi merr në konsideratë edhe tendencat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe në përmbajtjen e tij reflekton zhvillimet e fundit në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit. Institucioni përmes këtij programi synon të përgatisë studentë të aftë për tju përgjigjur politikavë të zhvillimit të marra nga institucionet shtetërore dhe aplikimeve të fundit teknologjike të kërkuara nga fusha e biznesit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Ky program studimi është i shprehur edhe në misionin dhe objektivat afatgjatë të Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional 2017-2022, ku qëllimi është që “Albanian University”, të radhitet mes Institucioneve cilësore të Arsimit të lartë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.[dok 58-faqje 4]..</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>Në plotësimin e synimeve kryesore të tij ky program studimi vepron në respekt të Strategjise së Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike 2017 – 2018 dhe në respekt të objektivave specifike të tij të përcaktuara qartë në Rregullore [dok.45, dok.12, dok.9].</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Organizimi dhe të gjithë dokumentat ligjorë mbi bazën e të cilave ky program studimi është në zbatim mbështeten mbi aktet ligjore dhe nënligjore të MASR Rregullorja mësimore e programit të Studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”, mbështeten në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi, mbi Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të “Albanian University” [dok.45, dok.12, dok.9].</p> <p>Statuti i AU është riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë [dok.67-Statuti i AU].</p> <p>Në kuadër të detyrave të lëna nga Bordi i Akreditimit, Departamenti gjatë periudhës Korrik - Shtator 2017, ka rishikuar të gjitha kurrikulat e programeve <i>Bachelor</i> dhe <i>Master</i>, me objektiv përmirësimin e tyre. Rishikimi i kurrikulave është shoqëruar edhe me përshtatjet e rregulloreve të programeve të studimit me ndryshimet, si dhe me ligjin e ri të arsimit të lartë 80/2015 [dok. 42]</p> <p>Emërtimi i programit të studimit MSc në “Inxhinieri Elektronike” është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (Ligji Nr.10247, datë 4.3.2010, “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”).</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë ka hartuar një strategji afatshkurtër 2017 – 2018 e cila është në në linje veprimi dhe në përputhje me Strategjinë afatgjatë të zhvillimit 2017 -2022 të AU-së. Në synimin kryesor është politika e mesimdhënies, studentët dhe ndërkombëtarizimi përmes projekteve kërkimore shkencore.</p> <p>Në rritjen e cilësisë së mësimdhënies evidentojmë përpjekje nga drejtuesit e departamentit të inxhinierivë për rekrutim të një stafi akademik me eksperiencë profesionale dhe akademike si edhe përmirësim të formave të mesimdhënies vecanerisht në orët laboratorikë</p>

dhe praktikave profesionale [takim me stafin akademik, takim me drejtues të departamentit të inxhinierive, takim me studentët].

Konkluzionet e vlerësimit:

- Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike në Universitetin Privat “Albanian University” është në përputhje me qëllimin, misionin e vet universitetit.
- Ky program ka të qartë objektivat e tij të shprehur në Rregulloren e Programit të Studimit, dhe funksionin mbi bazën e një strategjinë afatshkurtër 2017 – 2018 e cila është në akordancë me strategjinë afatgjatë 2017 – 2022 të institucionit.
- Programi i studimit ndjek një politikë përmirësimi të vazhdueshëm që reflekton kërkesat e tregut të punës mbi bazën e një studimi të kryer dhe mbi bazën e ndryshimeve ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

GVJ konkludon që:

Standardi I.1 mendojmë se **përmbushet**;

Standardi I.2 mendojmë se **përmbushet**;

Standardi I.3 mendojmë se **përmbushet**;

Standardi I.11 mendojmë se **përmbushet**;

Përfundim: Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti Privat “Albanian University” është një strukturë e përbërë nga njësi akademike dhe kërkimore të organizuara në 3 Fakultete dhe secila prej tyre e strukturuar në departamente.

Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;**
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Programi Master i Shkencave në **Inxhinieri Elektronike** ofrohet nga departamenti i Inxhinierisë në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë.

Ky fakultet përbëhet nga tre njësi bazë:

- **Departamenti i Inxhinierive**
- **Departamenti i Arkitekturës**
- **Departamenti i Shkencave Ekonomike**

Institucioni permes Statutit dhe Rregulloreve në nivel Fakulteti dhe program studimi ligjëron funksionin e organeve drejtuese mësimore, administrative dhe vendimarrëse.

Autoritetet kryesore të cilat ndikojnë në vënien në funksion të programit të studimit janë:

- **Senati Akademik** që është struktura më e lartë drejtuese dhe vendimarrëse e Universitetit. Përbëhet nga 19 anëtarë ku 18 prej tyre janë personel akademik dhe 1 është përfaqësues i studentëve (Kryetar i Këshillit të Studentëve të AU-së) [dok 67 – Statuti, neni 19, pika 6];
- **Bordi Administrativ** që është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili ka kompetenca vendimarrëse dhe supervizimi mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të universitetit [dok. 67 – Statuti, neni 31]
- **Rektori** që është funksionari më i lartë akademik [dok.67 – Statuti, neni 28]; .
- **Administratori**- është autoriteti më i lartë drejtues administrativ i Universitetit, i cili drejton Bordin Administrativ duke gëzuar të drejtën e votës [dok.67 – Statuti, neni 31].
- **Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë (ZBSC)** realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së aktivitetit akademik.
- **Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës** – që mbikqyr, promovon dhe orienton përmirësimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të kurrikulës.
- **Zyra e Këshillimit të Karrierës**
- **Përgjegjesi i Departamentit të Inxhinierise**, përgjegjës edhe për programin Master i shkencave në Inxhinieri Elektronike, është PhD. Genta Rexha. Departamenti i inxhinierive është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet. Në Statut dhe në Rregulloren e Fakultetit si dhe në Rregulloren e Programit të studimit janë shprehur qartë detyrat dhe përgjegjësitë në veprimtarinë e departamentit në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Puna e tyre pasqyrohet përmes planeve të punës, informacioneve që ofrojnë, raporteve semestrale dhe vjetore të cilat depozitohen në zyrën e Dekanatit [dok.67 – Statuti, neni 30].
- **Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike** e cila është një njësi bazë me strukturë dhe me personel të veçantë. Fusha e kërkimit nga kjo qendër është në përputhshmëri me strategjinë e zhvillimit të departamenteve. Ajo koordinon planin e punës shkencore me departamentin e inxhinierisë si edhe merr pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara përbëhet nga:

- *Departamenti i Inxhinierive*
- *Departamenti i Arkitekturës*
- *Departamenti i Shkencave Ekonomike*

Fakulteti në vitin aktual akademik **2017-2018** ka në përbërjen e tij **122** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **67** persona, nga të cilët **42** janë me tituj/grada, ~~5 janë Dr. në proces dhe 30 janë me gradën MSC,~~ ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **55**, nga të cilët **44** me tituj/grada, **4** me gradën DR. në proces dhe **7** janë me gradën MSc. (sipas Tabelës nr. 1 në RVB)

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Inxhinierive në vitin aktual akademik **2017-2018** ka në përbërjen e tij **37** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **23** persona, nga të cilët **10** janë me tituj/grada, **2** janë me gradën Dr. në proces, **11** janë me gradën MSc, ndërsa Personel

Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej 14, nga të cilët 13 me tituj/grada dhe 1 me gradën MSc..(sipas Tabelës nr. 1 në RVB).

Në vitin akademik 2017-2018 për programin e studimit janë angazhuar 5 PAE me gradën Dr dhe 2 PAK me gradën përkatësisht Prof.Asoc dhe Dr. Departamenti i Inxhinierive koordinon mësimdhënien me njësitë e tjera, sidomos me departamentet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të infrastrukturës.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Vendet vakante për staf akademik për vitin akademik 2017 – 2018;

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p> <p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” në Statut ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e organeve kolegjiale dhe administrative. Qëllimi kryesor i mbarëvajtjes së punës së tyre lidhet drejtpërdrejtë me përmbushjen e misionit dhe strategji afatgjatë të universitetit ku sipas neneve 21, 22, 28, 29, 31 të këtij Statuti jepen detyrat e organeve kolegjiale dhe mandatet përkatëse të tyre.</p> <p>Aktualisht AU përbëhet nga tre fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore; 2. Fakulteti i Shkencave Shoqërore; 3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike; <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Inxhinierive; • Departamenti i Arkitekturës; • Departamenti i Shkencave Ekonomike; <p>Ky program ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive. Misioni dhe objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. [dok.40 – Rregullore e FAE, dok.13 – Rregullore e Programit të studimit, dok. 44 Rregullore e AU-së date 22.12.2016].</p> <p>Për vitin akademik 2017 – 2018 Departamenti i Inxhinierive ka në përbërjen e tij 23 pedagogë efektive (PAE), nga të cilët 2 kanë titullin Prof.Asoc.Dr., 8 mbajnë titullin Dr., 2 pedagogë janë në proces dokotorature dhe 11 janë me MSc. dhe 14 pedagoge me kohë të pjesshme(PAK). Në vitin akademik 2017-2018 për programin e</p>

	<p>studimit janë angazhuar 5 PAE me gradën Dr dhe 2 PAK me graden përkatësisht Prof.Asoc dhe Dr.</p> <p>Verifikimet u bënë gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore ku u morrën edhe të dhëna në lidhje me numrin e stafit akademik (PAK dhe PAE) të angazhuar për vitin 2017-2018</p> <p>Synohet që për këtë program studimi të angazhohet një personel akademik me eksperiencë ndonëse nga takimet e kryera me Dekanin e FAE dhe shefin e departamentit të Inxhinierise si edhe me përgjegjësen e zyrës së burimeve njerëzore u theksua vështirësitë në rekrutimin e një stafi te kualifikuar.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive që është edhe njësi bazë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ndërmerr një politikë të qartë në lidhje me programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike.</p> <p>Ndërtimi i programit dhe rishikimi i vazhdueshëm i tij në masën 20% bëhet në përputhje me misionin dhe qëllimin e vet institucionit. Nga takimi me Dekanin e Fakultetit, Përgjegjësen e Departamentit si dhe takimi me stafin akademik, u diskutua për punën e kryer nga ky departament për përmiresimin e programit të studimit përmes një kombinimi të mirë të veprimtarisë mësimore me atë kërkimore shkencore, gjithmone në rritje të aftësisimit të studentëve dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Evidenca të qarta u dhanë në lidhje me procesin gjithpërfshirës të stafit në procesin e rekrutimit të stafit akademik me kohe të plotë dhe të pjesshme.</p> <p>Sipas dokumentave të siguruar nga DVV dhe informacionit dhe dokumentacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion GVJ konstaton se</p>
	<p>Departamenti i Inxhinierive dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përfshihen në procesin e rekrutimit dhe vlerësimin të stafit akademik.</p> <p>Kërkesa për staf akademik buron nga Departamenti i Inxhinierive [dok. 70-Kërkesë për plotësim mE staf akademik].</p> <p>Kjo kërkesë diskutohet në mbledhjet departamentit të inxhinierive në fillim të çdo viti</p>

akademik dhe merr formën përfundimtare me Vendim të Senatit Akademik [dok.72 –Vendim Senati Akademik për Rekrutimet].

Procesi i rekrutimit në universitetin “Albanian University” është përshkruar në dokumentin nr.60 “Procedura e rekrutimit”.

Shefi i Departamentit të Inxhinierive është pjesë e komisionit adhoc. Dokumenti nr. 72 “Rekrutimi i stafit akademik për vitin akademik 2017 – 2018” pika 3.c vërteton që institucioni, mbart një eksperiencë në lidhje me rekrutimin e stafit akademik dhe të dhënat statistikore tregojnë që 65% i përket kategorisë së stafit akademik të qëndrueshëm duke konsideruar eksperiencën 14 vjeçare të institucionit. Vlerësimi i Performancës së stafit akademik është rregulluar me anë të dokumentave baze ligjore institucionale dhe përmes formularit të vetvleresimit të pedagogut [dok.22 – model raport vetvlerësimi të pedagogut].

Departamenti i Inxhinierive në bashkepunim më njësitë e tjera si NJSBC zbaton instrumenta vlerësimi dhe matje të vazhdueshme të përfundimit të stafit akademik në mesimdhënie.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Universiteti Privat “Albanian University” në Statut ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e organeve kolegjiale dhe administrative.
- Qëllimi kryesor i mbarëvajtjes së punës së tyre lidhet drejtpërdrejtë me përmbushjen e misionit dhe strategjise afatgjatë të universitetit Universiteti Privat “Albanian University.
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka tre departamente dhe programi i studimit MSc. Inxhinieri Elektronike zhvillohet në Departamentin e Inxhinierive. Ky departament funksionon mbi bazën e një strategjie afatshkurtër 2017 – 2018 e ndërtuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e vet FAE dhe të institucionit në tërësi.
- ~~Departamenti i Inxhinierive përmbush kriterin për numrin e stafit akademik me gradë shkencore.~~
- Institucioni ka të përcaktuar qarte procedurat për rekrutim të stafit akademik. Vleresojme që këto politika janë gjithpërfshirëse ku departamenti i inxhinierive luan një rol aktiv dhe vendimtar në to.
- Vlerësimi i Performancës së stafit akademik është rregulluar me anë të dokumentave baze ligjore institucionale dhe përmes formularit të vetvleresimit të pedagogut.

GVJ konkludon që:

Standardi II.2 mendojmë se përmbushet;

Standardi II.3 mendojmë se përmbushet;

Përfundim: Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Në bazë të Statutit të Universitetit “Albanian University”, Departamenti i Inxhinierive ne Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Programi MSc. në “Inxhinieri Elektronikë” zhvillohet në këtë departament. Për realizimin e këtij programi angazhohet stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Puna e departamentit të inxhinierive mbështetet edhe nga Njësitë Ndihmëse dhe Administrative [Statut, neni 12 dhe 13].

Departamenti i Inxhinierive drejtohet nga një personel i kategorive të mëposhtme:

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme;
2. Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor;
3. Personeli ndihmës –akademik me karakteri administrativ;

Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës [dok. 38 – Kontratë PAK dhe PAE], në Rregulloret baze përkatesisht të AU-së, të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në Rregulloren për Programin e Studimit Master [dok.12, 40 dhe 45].

Aktualisht janë të angazhuar për programin MSc “Inxhinieri Elektronikë” stafi i mëposhtëm:

- **Personeli Akademik**

Për vitin akademik 2017-2018 në programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike janë angazhuar 7 pedagogë gjithsej nga ku 5 pedagogë si PAE dhe 2(PAK) [dok. 123 ngarkesa mësimore e stafit akademik 2017 – 2018].

PAE: 5 Dr..

PAK: 1 Prof Asoc.Dr., 1Dr,

- **Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor:**

Si personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor angazhohen 2 asistentë departamenti;

- **Personeli ndihmës –akademik me karakteri administrativ;**

1 Kryesekretare e FSHAE [vizite ne terren]

2 Sekretare mësimore për programet e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri [vizite ne terren]

1 Administratore e FSHAE [vizite ne terren]

2 Punonjëse e bibliotekës së FSHAE [vizite ne terren]

1 Përgjegjës IT [vizite ne terren]

2 Specialist IT [vizite ne terren]

Departamenti i Inxhinierive koordinon mësimdhënien me njësitë e tjera, përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës dhe laboratoreve.

• **Raportet Staf Akademik-Studentë – Ngarkesë Mësimore**

Viti Akademik	PAE/PAK	Student/PAE	Student/Staf Total
2017-2018	5/2 (2)	55/5 (11st/ 1 PAE)	55/7 (7.9 st /1 Pedagog)

Viti Akademik	Ngarkesa mësimore e realizuar			
	PAE në % (orë)	PAK në % (orë)	Nga PAE me tituj e grada në % e totalit	Nga PAK me tituj e grada në % e totalit
2017-2018	81% (789 orë)	19% (186 orë)	100%	100%

Ngarkesa mësimore mbulohet në masën 81% nga stafi akademik me kohë të plotë. Raporti student me PAE është dukshëm pozitiv. Departamenti i Inxhinierive mbulon me 100% programin e studimit me staf akademik me graden Dr. Raporti student staf është 7.9/1 . Këto shifra pozitive tregojnë punën e Departamentit të Inxhinierive në lidhje me politikat përmirësuese që ka marrë në këtë drejtim dhe në përmbushje të rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve përmes akteve ligjore dhe nënligjore të saj.

Të dhënat sipas seksit

Në këtë program studimi angazhohen dy pegagoge femra nga 7 staf akademik në total.

Të dhëna sipas moshës së personelit

71.4% e stafit akademik i përkasin grup-moshës 36-45 vjeç.

14.3 % e stafit akademik i përkasin grup – moshës 46-55 vjeç;

14.3% e stafit akademik i përkasin grup – moshës 56-65 vjeç;

Evidentojmë një përfshirje në stafin administrativ dhe ndihmës – mësimor të grup-moshës së re.

72.7% personelit ndihmës – akademik me karakter administrativ i përkasin grup-moshës 25-35

vjeç, ndërsa në lidhje me personelin ndihmës – mësimor institucioni synon një staf me eksperincë

(18.2% i përkasin grup-moshës 66-68 vjeç);

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Departamenti i Inxhinierive i cili është edhe përgjegjës për programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike ndërmerr një politikë të qartë në lidhje me angazhimin e një stafi akademik i cili mbart eksperiencë në fushën profesionale. Takimi me Dekanin e FSHAE theksoi synimin e institucionit për përmbushjen e kërkesave me staf akademik me kohë të plotë. Takimi me shefen e Departamentin të Inxhinierive dhe stafin akademik tregoi vështirësitë në lidhje me përthithjen e nje stafi me eksperiencë dhe grada shkencore. Në lidhje me përmbushjen e nevojave me personel akadmeik dhe ndihmës mesimor ndiqet një proces i rekrutimit përshkruar në dokumentin nr.60 "Procedura e rekrutimit".Kërkesa për staf akademik dhe personel ndihmës-mesimor buron nga departamenti i inxhinierive dhe miratohet nga Senati Akademik. Shefi i Departamentit të Inxhinierive është pjesë e komisionit adhoc.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit akademik dhe ndihmës- mesimor jepen në Kontraten e Punës e hartuar mbi bazën e Kodit të Punës dhe akteve ligjore në fuqi. Institucioni i kushton një vemendje të veçantë hartimit të kontratës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektivë dhe ata me kontratë administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore. Cdo fillim viti akademik/semestër zyra e burimeve njerëzore bën përditësimin e informacionit mbi stafin akademik.

Institucioni për vitin akademik 2017 -2018 ka bërë ndryshime në përmbajtjen e kontratës së punës. Vendimi i Senatit Akademik nr. 12 datë 13.12.2017 sjell për kontratat e stafiat akademik PAE dhe PAK në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/125 si edhe Kodin e Punës në Republikën e Shqiperisë ndryshimet:

- Për kategorinë Profesor dhe Lektor (PAK) është përcaktuar kohëzgjatja pa afat e kontratës së punës me të drejtë ripërsëritje çdo vit në momentin e paraqitjes së lejes nga punëdhënësi;
- Kontratat e stafit akademik me kohë të plotë (PAE) për të gjitha kategoritë janë me afat të pacaktuar.
- Të drejtën e shkëputjes nga angazhimet e institucionit për kryerjen e vitit sabbatik një herë në shtatë vjet me miratimin e njësisë bazë, për periudha kohore deri në një vit, për të punuar për përparimin akademik;

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Oraret mësimore per vitin akademik 2017 – 2018;

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mesimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mesimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si edhe takimet në institucion evidentojmë që personeli akademik dhe ndihmës – administrativ dhe mesimor angazhohet në përputhje me objektivat e programit të studimit.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mesimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Detyrat e tyre janë të përcaktuara qartë në Statut, në Rregulloren e AU-se dhe në Rregulloren për programin e studimit. Personeli ndihmës –akadmeik me karakter mesimor i nënshtrohet procesit te vlerësimit nga

	<p>drejtues të departamentit të inxhinierive.</p> <p>Në strategjinë e zhvillimit të institucionit theksohet përmirësimi i laboratorëve ekzistues dhe hapje të reja të tyre në përputhje me përmbajtjen e kurrikulave. Në këtë drejtim evidentojmë përpjekje të institucionit në angazhim të një personeli ndihmës –mësimor më eksperiencë.</p> <p>Aktualisht për vitin akademik 2017 – 2018 janë punësuar si personel ndihmës – administrativ 9 persona të cilët i përkasin grup moshës 25-35 vjeç dhe 2 janë personel ndihmës mësimor të grup moshës 65-68 vjeç dhe janë me eksepriencë në këtë fushë.</p> <p>Për përzgjedhjen e personelit ndihmës akademik përdoret e njëjta procedure rekrutimi. Kërkesat burojnë nga Departamenti i Inxhinierive dhe miratohen përmes ndjekjes së një politike transparente rekrutimi.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik (aktualisht 7 total, nga ku 5 PAE dhe 2 PAK) të angazhuar në këtë program studimi synojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës në masën 20%.</p> <p>Në përmirësimin e saj një kontribut japin edhe pedagogë të tjere të departamentit të inxhinierisë. Për përmirësimin e kurrikulës ndiqet një politikë e qartë dhe e vazhdueshme nga ana e Departamentit [dok 51, 52] e cila mbështetet në ndryshimet e bera nga MASR, si dhe ndryshimet në syllabuseve e nxitur nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [dok. 54 dhe 55].</p> <p>Diskutimet bëhen në departamentin e inxhinierive dhe janë të hapura [dok-shembull praktike mbledhje].</p> <p>Vlerësojmë që rekrutimi i personelit akademik PAE dhe PAK bëhet në përputhje me procedurat e rekrutimit të Institucionit.</p> <p>Në fillim të vitit akademik 2017 – 2018, departamenti shpalli kërkesat e tij për rekrutim. Gjatë fazes së rekrutimit, departamenti me procedura konkurruese zgjodhi 3 pedagogë të rinj me gradën shkencore Dr. dhe 1 pedagog me titullin Prof. Asoc. Dr., 1 pedagog i jashtëm me gradën Dr. kaloi si i brendshëm, 1 pedagog i larguar me titullin Prof. Asoc. Dr. u rikthye sërish pranë Departamentit.</p> <p>Gjithashtu, në këtë fazë rekrutimi u përzgjedhën edhe 3 asistentë-lektorë me MSc. [dok. 26 – Raporti vjetor 2017-2018].</p> <p>Në nevojat për vitin e ardhshëm akademik janë 5 pedagogë si PAE dhe 2 personel ndihmes akademik.</p>

Ngarkesa e personelit akademik jepet në kontratën e punes dhe përcaktohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

Marrëdhëniet e punësimit të personelit akademik të AU rregullohen bazuar në kontratat individuale të punës, bazuar në legjislacionin e punes dhe atë të Arsimit të Lartë në fuqi. Vendet e punës për personelin akademik në AU fitohen nëpërmjet një procedure konkurruese.

Kriteret e konkurrimit propozohen nga departamenti i inxhinierive dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe nga Senatit Akademik. Kandidatët konkurrojnë në përputhje me afatet e shpallura nga AU të cilat bëhen publike në website të universitetit eëë.albaniauniversity.edu.al si edhe në median elektronike. Kontrata e punës lidhet pa afat ose me afat të përcaktuar.

Institucioni në Statut ka përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila shërben për ndjekjen e procedurës së rekrutimit të stafit akademik, stafit administrativ ndihmës dhe mësimit.

Personeli akademik efektiv(PAE) i angazhuar në programin e studimit MSc në "inxhinieri Elektronike" përbën rreth 71% të personelit akademik total, ndersa ngarkesa mësimore që stafi PAE mbulon për këtë program studimi është 975 orë ose 81%.

Departamenti i Inxhinierive në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe me NJSBC ndjekin një politikë të qartë në lidhje me vlerësimin e stafit akademik.

Departamenti i Inxhinierive zhvillon kontrolle periodike të stafit akademik. Kontrollat konsistojnë në mënyrën e organizimit të leksionit, përmbajtja e tij me programin mësimor, marrëdhëniet pedagog - student etj.

Gjithashtu në fund të çdo semestri bëhet një vlerësim i stafit akademik përmes përdorimit të një model raporti të vlerësimit të pedagogut [dok. 22]. Vlerësimi bëhet edhe në fund të mbarimit të kurrikulës dhe mbi bazën e të dhënave sasiore dhe cilesore të përpunuara bëhen edhe përmirësimet e duhura në mësimdhënie ose në mos rinovim kontrate për raste të përsëritura dhe abuzive.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjësi i Departamentit, Dr. Genta Rexha, është edhe përgjegjëse e programit të studimit.

Në këtë program studimi angazhohen 5 pedagogë si PAE të cilët kanë titullin “Doktor i Shkencave” dhe 2 titullarë si PAK përkatësisht me gradën Prof. Asoc. dhe Dr.

Personeli ndihmës -administrativ dhe ndihmës -mësimor angazhohet me kohë të plotë për të siguruar mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit. Aktualisht angazhohen për këtë program studimi 2 personel ndihmës mësimor dhe 9 si personel ndihmës – administrativ. Në këtë personel ndihmës-administrativ janë kryesekretarja, sekretaria mësimore, specialiste IT, zyra e regjistrimeve, zyra e burimeve njerëzore, punonjëse të bibliotekës etj.

Drejtimesit e njësive, Rektori, zv/Rektori, Dekani, Zv/Dekani, si dhe Përgjegjësi i Departamentit, janë të punësuar me kohë të plotë në AU. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë të përcaktuara qartë në Statut.

AU angazhon kryesisht si titullarë të lëndëve, moduleve personel akademik i cili minimalisht ka gradën shkencore Doktor

Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Praktikave profesionale behen sipas një kalendari akademik. Ato janë të përcaktuara qartë sipas nenit 28 në Rregulloren e programit të studimit. Mbi bazën e saj Departamenti i Inxhinierive bën edhe kërkesën për miratim pranë Dekanatit të FAE. [dok. 34 – Përcaktimi i udhëheqësve për praktikave profesionale].

Bazuar në VKM Nr. 418 datë 10.05.2017 çdo pedagog ka në mbikëqyrje jo më shumë se 20 studentë.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatitin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;

Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara

Studentet kanë të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit [dok. 13 - Kreu V, nenin 31 dhe 32] detyrimet për diplomim.

Proçesi i diplomimit realizohet me anë të mbrojtjes së një teze, tema e së cilës miratohet nga Departamenti brenda një muaji nga fillimi i vitit të dytë akademik.

Mbrojtja e temës së diplomës bëhet në tre sesione diplomimi të cilat përcaktohen nga dekani i Fakultetit.

Udhëheqësi ka detyrimin për të ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Grada shkencore e udhëheqësit të

<p>në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>diplomes është Dr. dhe në nenin 32 të kësaj Rregullore është përcaktuar qartë që udhëheqësi nuk mbikqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar dhe fusha e ekspertizes së tij është në përputhje me temën e zgjedhur të diplomës nga studentit.</p> <p>Për vitin akademik 2017 – 2018 janë dhënë 24 tema diplome [dok.33 – temat e diploma për inxhinieri elektronike].</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Nga tabela e temave të diplomave të dhënë në RVB dhe nga takimi me stafin akademik gjejmë një përputhje të trajtimit të temës së diplomës me fushën e ekspertizës së vet stafit akademik.</p> <p>Për vitin akademik 2017 – 2018 është aktivizuar si udhëheqës diplome edhe staf PAK (Desar Shahu – 4 diploma).</p> <p>Aktivitetet shkencore dhe botimet e stafit akademik ndikojnë në aftësimin e stafit akademik dhe në një konkretizim më të mirë të trajtimit të temës së diplomës tek studentit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Albanian University” angazhon një staf ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve praktike laboratorike dhe për mirëmbajtjen e mjediseve shkollore (ambjentet si sallë interneti, salla e bibliotekës etj).</p> <p>Për programin e studimit MSc. Inxhinieri Elektronike angazhohen 2 persona si personel ndihmës – mësimor me eksperiencë në këtë fushë. Kontributi i tyre është në mbarëvajtjen e orëve laboratorike, ndërsa drejtimi i seancave laboratorike zhvillohet nga titullarët.</p> <p>Stafi ndihmës është në gadishmëri për studentë të cilët kërkojnë të punojnë në laboratore (përmes marrjes së një leje paraprake nga departamenti).</p> <p>Raporti personel akademik/ ndihmës – akademik për vitin aktual është si më poshtë vijon: 7/2/9/55 (7 pedagog për programin e studimit/ 2 personel ndihmës – mësimor/ 9 personel ndihmës administrativ / 55 studentë).</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi</p>	<p>Në programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike angazhohen 5 titullarë me gradën DR. si PAE dhe 2 titullarë me gradën Prof. Asoc dhe Dr. si PAK.</p> <p>Ngarkesa mësimore që stafi PAE mbulon për këtë program studimi është 975 orë ose 81%.</p> <p>Nga ana tjetër duke konsideruar kontributin që ky</p>

Handwritten marks and signatures at the bottom of the page.

i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

staf jep edhe për programe të tjera evidentojmë një mbi ngarkesë përkatësisht:

Stafi PAE

- a) Leke Pepkolaj: 60/ 716 orë
- b) Genta Rexha: 135/442 orë
- c) Miranda Harizaj: 120/713 orë
- d) Fatmir Basholli: 154/497 orë
- e) Klodian Kurti:46/261 orë

Stafi PAK:

- a) Desari Shahu 61 ore
- b) Bexhet Kamo: 125 orë

Ngarkesa mësimore që stafi akademik realizon për programin e studimit MSc. Inxhinieri Elektronike është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, por duke konsideruar shifrat më sipër që japin edhe ngarkesën totale të këtij stafi në angazhimet e tij edhe në programin Bachelor, evidentojmë një mbingarkesë për tu marrë në konsideratë.

Numri i lëndëve që ky staf jep është konsideruar i madh. Aktualisht më poshtë evidentojmë:

- a) Leke Pepkolaj: 1/8 lëndë
- b) Genta Rexha: 2/7 lëndë
- c) Miranda Harizaj: 2/16 lëndë
- d) Fatmir Basholli: 3/12 lëndë
- e) Klodian Kurti: 1/5 lëndë

Kjo u aprovua edhe nga drejtuesit e këtij institucioni. Një nga arsyet e përshpejtimin të procesimit të rekrutimit përmes Vendimit të Senatit Akademik edhe për semestrin e dytë është nevoja për staf me eksperiencë.

Duke konsideruar Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Inxhinierive për vitin 2017 – 2018, ku një ndër synimet e tij është edhe hapja e dy degëve të reja përkatësisht Master Profesional në Sisteme të Energjisë, Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike, konsiderojmë që ngarkesa e stafit akademik do të rritet më shumë [dok.42 – Plani Strategjik I Zhvillimit të Departamentit; dok.43- Kërkesë për hapje të programeve të reja]

Ndonëse nuk kemi të dhëna dhe nuk mund të përcaktojmë në mënyrë eksplicite impaktin që kjo mbingarkese ka në cilesinë e mësimdhënies, e konsiderojmë si një faktor për tu marrë në konsideratë.

Rekomandojmë që institucioni duhet të plotësojë nevojat e departamentit të inxhinierisë duke gjetur instrumentat e duhur dhe mbuluar këtë kërkesë

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për

AU ka Departamentin e Burimeve Njerëzore që shërben edhe si Arkivë për mbajtjen e të gjithë të dhënave. Të dhënat mbahen edhe në departamentin

Handwritten signatures and initials.

organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

e inxhinierisë. Këto të dhëna kanë të bëjnë me personelin akademik dhe ndihmës mësimor të angazhuar në lëndët për çdo semestër akademik. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike publikon në çdo fillim viti, programin mësimor së bashku me personelin akademik të angazhuar për secilen lëndë [**dok.8-plani mwsimor; dok.21 – kalendari akademik**].

Institucioni harton qarte kriteret e konkurrimit ne procedurat e rekrutimit qe ajo shpall ne fillim te cdo viti akademik. Kriteret shpallen ne faqen kryesore website të AU-së, ne media elektronike dhe në Shërbimin Kombëtar të Punesimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar ne RVB, dokumentacionin perkates dhe vizitave të kryer ne institucion, takimet me drejtuesit e departamentit te inxhinierise, stafin akademik vizitën në zyrën e Byrimeve Njerëzore, evidentojmë që:

- Universiteti Privat “Albanian University” ndjek një politikë të qartë ligjore rekrutimi në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e FAE dhe të programit të studimit.
- Kërkesat për staf akademik janë në akordancë me Strategjinë Afatshkurtër të Departamentit të Inxhinierive dhe në përputhje me Strategjinë Afatgjatë të institucionit. Departamenti i inxhinierive është përpjekur të përmbushë kriterin që të gjithë lëndët të mbulohe me staf akademik me gradën Dr. me kohë të plotë, por nga ana tjetër evidentojmë një mbingarkesë të këtij stafi e cila ka impaktin e saj në cilësinë e mësimdhënies të vet programit të studimit.

Për sa më sipër rekomandojmë: *Departamenti i Inxhinierive duhet të plotësojë nevojat e tij me staf akademik të plotë dhe me kohë të pjesshme për të garantuar aktivitetet e tij në programet mësimore dhe për iniciativat e reja qe ai synon të ndërmarre*

- Evidentojmë përpjekje të institucionit, angazhime të hallkave kryesore të tij si Senati Akademik për të ndërmarrë procedura rekrutimit të stafit edhe në semestrin e dytë gjë që shpreh një vullnet pozitiv për të përmbushur këtë kërkesë.
- Kontratat e stafit akademik PAK dhe PAE janë të ndërtuar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe bazuar në Kodin e Punës. Kontratat janë subjekt përmirësimi i vazhdueshëm. Vendimi i fundit i Senatit Akademik shpreh ndjekjen e një politike të tillë nga institucioni.
- Në programin e studimit MSc. Inxhinier Elektronike angazhohet staf ndihmës – mësimor dhe administrativ me eksperiencë dhe disponibël. AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Një mënyrë e periodike vlerësimi janë pyetësoret e vlerësimit nga studenti të programit dhe mësimdhënies. Departamenti i inxhinierisë angazhon një personel të kualifikuar dhe me eksperiencë të gjerë në fushën e kërkimit me gradën “Doktor” si titullar të modulit.
- Procesi i mësimdhënies i nënshtrohet një proces vlerësimi periodik dhe është ne përmirësim të vazhdueshëm
- Institucioni ndjek të gjithë procedurat e duhura për udhëheqjen e tezës së diplomës nga studenti në fund të perfundimit të ciklit të studimeve..

GVJ konkludon qe:

Standardi II.1- mendojmë se **përbushet**;
Standardi II.4- mendojmë se **përbushet**
Standardi III.1- mendojmë se **përbushet**
Standardi III.2- mendojmë se **përbushet**
Standardi III.5- mendojmë se **përbushet**
Standardi III.6- mendojmë se **përbushet**
Standardi III.7- mendojmë se **përbushet**
Standardi III.8- mendojmë se **përbushet kryesisht**
Standardi III.9- mendojmë se **përbushet**

Standardet e kësaj fushe janë përbushur kryesisht;

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Departamenti i Inxhinierive si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike zhvillon aktivitetin e tij në mesin e cila ndodhet në adresën “Rruga e Kavajës”.

Ambjentet e kësaj godine zotërohen nga AU në bazë të kontratës së qerasë datë 23.03.2018 me Nr. 1556 Rep, Nr. 469 Kol lidhur me pronarët me afat kohor të kontratës deri në datë 01.04.2028 [**dok.82-Kontratë qeraje**]. Nga vizita në institucion vlerësojmë qe ambjentet e ndërtesës janë të përshtatshme për leksione, praktika dhe laboratorë. Infrastruktura është moderne dhe sallat janë në përputhje me standartet teknike për mësimdhënie. Hapësirat e klasave janë të mëdha dhe me dritë. Disponohet edhe sallë interneti. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ndodhet në të njëjtën ndërtesë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Biblioteka është e pajisur me të gjithë aksesoret dhe lehtësirat për një studim dhe marrje informacioni. Salla është e pajisur me tavolina studimi dhe kompjutera. Interneti është në dispozicion gjatë orëve të studimit por edhe në punën kërkimore shkencore të pedagogëve.

Për programin e studimit janë në funksion edhe laboratorët e mëposhtëm:

- **Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve)** konsistojnë në dy salla kompjuterash, në të cilët janë instaluar softëra të ndryshëm, të përdorur në ambjentet akademike inxhinierike ndërkombëtare për programimin dhe simulimin e sistemeve të ndryshme inxhinierike. K
- **Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave** - Në njërin prej laboratorëve të informatikës, janë instaluar pajisje, përmes të cilave mundësohet realizimi i një numri të madh punësh laboratorike, në drejtim të rrjetave të telekomunikacionit, kryesisht në kuadër të programeve Master i Shkencave.
- **Laboratori i Elektroteknikës**, i pajisur me instrumenta e aparatura të ndryshme në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës, e afron studentin gjithmonë e më shumë me një vëzhgim

praktik të njohurive të marra në auditor, në këtë rast në lëndët Elektroteknikë 1 dhe Elektroteknikë 2.

- **Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale** përmban module me gjysëmpërçues dhe qarqe të integruara, duke ju dhënë mundësinë studentëve që të realizojnë matje të ndryshme dhe të nxjerrin karakteristikat e elementëve bazë të qarqeve elektronike. Laboratori përmban edhe module zhvillimi, në të cilat studentët mund të ndërtojnë dhe testojnë skema të ndryshme të hartura nga vetë ata. Matja në laborator mund të realizohet me simulimin e aparateve dixhitale dhe analoge ose nëpërmjet një softëare-i kompjuterik, i cili mundëson përpunime të mëtejshme të matjeve. •
- **Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike** është i pajisur me aparatura bashkëkohore, të cilat bëjnë të mundur realizimin e punëve laboratorike të lëndëve Matje elektrike dhe elektronike 1 dhe 2, dhe pjesërisht të lëndëve Sensorët dhe instrumentim procesesh 1 dhe 2. Gjatë këtyre punëve laboratorike, studenti njihet me strukturat e aparateve dhe metodat e matjes së madhësive të ndryshme elektrike.
- **Laboratori i automatikës dhe kontrollit** (dhe Mekatronikës) përmban një impiant i cili mundëson disa procese, kontrolli i parametrave të të cilëve realizohet drejtëpërdrejtë nga studentët nëpërmjet modulit të kontrollit. Kontrolli mund të realizohet, gjithashtu, edhe nëpërmjet PLC-së (Programmable Logic Controller). Programet e kontrollit për PLC-në, ndërtohen nga vetë studentët. Matjet e realizuara përpunohen më tej nga softëare-i përkatës.
- **Laboratori i makinave elektrike** është i pasuruar me pajisje të teknologjisë së fundit, që mundësojnë studimin eksperimental dhe simulimin e pajisjeve dhe sistemeve të trajtuara dhe studiuar teorikisht në lëndët Makina elektrike 1 dhe 2, Transmisione elektrike dhe disiplina të tjera të përafërta.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Sallat për leksione, për seminare, laboratorët, salla e internetit biblioteka dhe mjedise të tjera ndihmëse dhe rekreative janë në përputhje me përshkrimet e bëra në RVB dhe në akordancë me standartet e kërkuara për një cilësi në mësimdhënie.

1. Klasat për leksione dhe seminare janë të përshtashme për të përballuar fluksin e studentëve;
2. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë;
3. Klasat, laboratorët dhe ambientet e brendshme janë të lidhura me një sistem HVAC që siguron një komfort teknik të duhur sipas standarteve;
4. Klasat janë të ndricuara mirë dhe në korridore dhe holle janë të vendosur skemat e evakuimit dhe të emergjencës.

Norma është 23.20 m²/student.

Mjediset për stafin:

Institucioni ka krijuar mjedise të duhura për stafin akademik në mënyrë që të garantojë sipas standarteve kushte të duhura për mësimdhënie dhe për zhvillim shkencor. Norma për stafin akademik është 3.41 m²/për person.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” zotëron disa godina. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ndodhet në adresën “Rruga e Kavajes”. Mjediset ku zhvillohet ky program kanë një stabilitet për një periudhë mbi 10 – vjeçare [dok. 31 – planimetritë dhe kontratat e qerasë].</p> <p>Institucioni garanton ndjekjen e një politike të qartë në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës, përmes përmirësimit të laboratoreve dhe mjediseve përreth duke plotësuar edhe standartet e kërkuara për në program cilësor studimi. Konkretisht për plotësimin e rekomandimeve të Bordit të Akreditimit është hapur edhe Laboratori i Infrastrukturës së rrjetave. Në vizitën e kryer në institucion evidentuam që sallat e leksioneve, seminareve. Laboratorët dhe mjedise të tjera rekreative dhe ndihmese si sekretaria, zyrat e administratës dhe biblioteka janë funksionale dhe në akordancë me standartet teknike të zbatimit dhe standartet e cilësisë në mësimdhënië.</p> <p>Laboratorët janë të pajisur me mjetet dhe pajisjet bazë për temat që trajtohen [dok.84-përshkrimi i laboratoreve], ndërsa biblioteka është në pasurim të vazhdueshëm me libra dhe tekste mësimore [dok.83- kërkesë për pasurim të bibliotekës].</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>Për këtë program studimi ofrohen tekste mësimore dhe skripte. Biblioteka në katin e dytë shërben edhe si arshivë për skripte të programit të studimit. Biblioteka është e vendosur në godinën kryesore dhe ka dy ambjente. Në ambjentin e katit të dytë shërben për akomodimin e 50 studentëve për të studjuar dhe është e pajisur edhe me kompjuter dhe internet. Në shërbim të studentëve në vitin akademik 2017 – 2018 është hapur edhe mjedis i dytë me hapësirë të madhe ku mund të akomodohen mbi 100 studentë.</p> <p>Institucioni ndjek një politike të qartë në lidhje me pasurimin e saj [dok.30-Kërkesë pasurimin e bibliotekës]. Kërkesa për pasurimin e bibliotekës buron nga stafi akademik. Mbi bazën e përshtatjes së syllabuseve në çdo vit akademik, stafi akademik paraqet edhe kërkesa në departamentin e inxhinierisë për literaturë bashkëkohore. Aktualisht</p>

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

në vitin akademik 2017 – 2018 janë blerë 34 libra për fushën e inxhinierisë.

Biblioteka ka 104 tituj në fushën e inxhinierisë dhe mbi 335 kopje dhe vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik një listë të gjerë të librarisë online [dok.79-80-Lista e librave online] të aksesueshme nën kujdesin e specialistes të bibliotekës.

Vizita në bibliotekë evidentoi një funksion të rregullt të saj. Biblioteka funksionon në oraret: 8.00 - 16.00 nga e hëna deri të premten dhe 8:00 – 12:00 ditën e shtunë, orar ky të cilin ne e konsiderojmë për studentët e programit të studimit Msc. Inxhinieri Elektronike jo shumë të pershtatshem duke konsideruar zhvillimin e orëve të mësimi pasdite.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Konstatimi i GVJ është se AU zotëron godina të cilat ofrojnë një hapësirë të mjaftueshme për studim. Aktualisht MSc. ne Inxhinieri Elektronike zhvillohet në godinen nr.1 përshkrimi i të cilës është bërë qartë më sipër në përshkrimin e infrastrukturës.

Godina është e pajisur me auditorë të mëdhenj që kanë një kapacitet mbajtës prej 75 studentësh, për salla leksioni, salla seminari me kapacitet 30-50 studentë. Përveç kësaj në godinë janë të vendosur edhe laboratorë, sallë interneti. Çdo auditor dhe sallë leksioni është e pajisur me tabela të mjaftueshme për pedagogun. Sallat e seminareve janë të vogla që mundësojnë zhvillimin e praktikave (ore ushtrime) në grupe te vogla.

Mjediset mesimore janë të pajisura me mjetet didaktike për të mundësuar zhvillim korrekt të programit mesimor. Laboratorët janë të pajisur me aparaturat dhe mjetet e duhura dhe janë funksion i nje politike përmirësimi të vazhdueshem në përputhje me përmirësimet e programit të studimit në teresi dhe syllabuseve në vecanti.

Për këtë program studimi përdoren laboratorët e mëposhtëm:

- Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve)
- Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave
- Laboratori i Elektroteknikës
- Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale
- Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike
- Laboratori i automatikës dhe kontrollit
- Laboratori i makinave elektrike

Punët laboratorike kryhen në prani të pedagogut të laboratorit dhe laborantit dhe synohen të bëhen në

formën e simulimeve.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Vizita ne institucion dhe dokumentacioni i shqyrtuar na mundëson të konkludojmë se AU zotëron një infrastrukturë të duhur për një zhvillim korrekt dhe plotësim të standarteve të kërkuara për një institucion arsimor.
- Evidentojmë një stabilitet në infrastrukturë përmes kontratë të lidhur dhe me afat përdorimi deri në date 01.04.2018 dhe me të drejtë ripërseritje.
- Numri i sallave të leksioneve, seminareve janë të duhur për të përballuar numrin e studentëve që ndjekin studimet në këtë program. Punët laboratorike kryhen në prani të pedagogut të laboratorit dhe laborantit dhe synohen të bëhen në formën e simulimeve.
- Aktualisht departamenti i inxhinierise ka 7 laboratorë për këtë program studimi dhe synohet përmes një politikë të qartë institucionale përmirësimi i vazhdueshëm i tyre.
- Në funksion të studentëve është edhe biblioteka e cila pasuron fondin e saj përmes kërkesave që burojnë nga stafi akademik dhe departamentet.

GVJ konkludon qe:

Standardi II.5- mendojmë se përmbushet

Standardi V.1- mendojmë se përmbushet

Standardi V.2- mendojmë se përmbushet

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti Privat “Albanian University” është një institucion privat ku burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe nga aktivitete të tjera tregtare. Të gjithë të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë në rritjen e kapaciteteve dhe në përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe laboratorike. Universiteti disponon një njësi manaxhimi të burimeve financiare dhe kontrollin e tyre. Universiteti harton cdo vit një raport financiar i cili auditohet edhe nga ekspertë kontabël te licensuar [Dok.9 shtese – raporti financiar 2015, 2016 dhe 2017; Raport ekspert kontabel per vitin financiar 2015, 2016 dhe 2017;].

Në raportin financiar jepen me detaje të ardhurat, shpenzimet operative, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe shumë të dhëna financiare të tjera. Universiteti rezulton me një bilanc financiar pozitiv duke arritur të mbulojë shpenzimet e tij dhe duke treguar qëndrueshmeri financiare. Burimet

financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. Tarifa për një student që ndjek studimet në MSc. në Inxhinieri Elektronike është 124 000 lekë.

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Të ardhurat janë nga tarifat për shkollimin. Ato zënë për vitin akademik 2017 – 2018 vlerën 10,725,000 lekë.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja e studentit për një vit akademik është 124,000 lekë. Bazuar në raportet financiare në shpenzime konsiderohen fondi i pagave të stafit akademik dhe ndihmës- mësimor dhe administrativ, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret për mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondi i ekselencës, bursat dhe kosto të tjera në mirëmbajtje.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Raport ekspert kontabël dhe raporti financiar për vitet 2015, 2016 dhe 2017;

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>AU është një institucion privat ku burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe nga aktivitete të tjera tregtare.</p> <p>Të gjithë të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë në rritjen e kapaciteteve dhe në përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe laboratorike.</p> <p>Universiteti disponon një njësi manaxhimi të burimeve financiare dhe kontrollin e tyre. Universiteti harton cdo vit një raport financiar i cili auditohet edhe nga ekspertë kontabël të licensuar. Nuk ka grante të huaja.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Universiteti harton cdo vit një raport financiar i cili auditohet edhe nga ekspertë kontabël të licensuar [dok.shitesë –raport auditimi për vitet financiare 2015,2016 dhe 2017].</p> <p>Në raportin financiar jepen me detaje të ardhurat, shpenzimet operative, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe shumë të dhëna financiare të tjera. Universiteti rezulton me një bilanc financiar pozitiv duke arritur të mbulojë shpenzimet e</p>

tij dhe duke treguar qëndrueshmeri financiare.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në RVB, si dhe takimet në terren theksojmë:

- AU paraqet qëndrueshmeri financiare pasi rezulton me fitim në vitet e fundit
- AU cdo vit, bën një auditim të jashtëm të situatës financiare;
- Çdo vit harton raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare;

GVJ konkludon qe:

Standardi II.9- mendojmë se përmbushet

Standardi VI.1- mendojmë se përmbushet

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë sigurimit të cilësisë. Plotësimi i këtij standarti mundësohet nga Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e parashikuar sipas nenit 11 në Statut. NJSBC është në varësi të Rektoratit të Universitetit dhe detyrat e përgjegjësitë e saj janë të parashikuara në nenin 14 të Rregullores së Brendshme të universitetit. Objektivi kryesor i kësaj zyre është zbatimi i politikave dhe kriterëve që garantojnë sigurimin e cilësisë në tërësi institucionale dhe në veçanti të programeve të studimit. NJSBC ka detyrimin e paraqitjes vjetore të raportit ku përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si edhe rekomandon masa që duhet të merren në lidhje me përmirësimin cilësor të mësimdhënies. Kjo njësi në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësim Institucional harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën të mundur hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese. Sistemi i brendshëm i cilësisë funksionon në cdo departament. Me vendim nr. 157/3 date 08.09.2016 Senati Akademik emëron edhe përfaqësues të SC në nivel departamenti. Departamenti i inxhinierisë për vitin akademik 2017 – 2018 përfaqësohet me Dr. Leke Pepkolaj dhe Dr. Fatmir Basholli Çdo vit anëtarësia e saj mund të rifreskohet sipas një kërkesë të bërë nga departamenti i inxhinierisë. Nje nga detyrat kryesore të

NJSBC është hartimi i anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat më tej shpërndahen në departamentin e inxhinierisë dhe pas plotësimit të tyre prej pedagogëve dhe studentëve ZBSC bën të mundur përpunimin statistikor të tyre duke nxjerr problematikën dhe rekomandon përmirësimet e duhura.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- NJSBC ka kryer dy anketime për vitin akademik 2017 – 2018 në fund të çdo semestri. Gjatë këtij viti janë anketuar 47% të studentëve ndërsa në semestrin e dytë kanë marrë pjesë 19% e tyre.
- Është kryer interviste me fokus – grupet, me 8 studentë të cilët janë shprehur pozitivisht në lidhje me programin e studimit dhe stafin akademik përkatës të tij;
- Është bërë vlerësimi nga departamentii inxhinierive në lidhje me respektimin e programit të studimit, aktivitete shkencore dhe marrëdhëniet me studentët të cilat janë shprehur edhe në raportet vjetore 2016-2017 dhe 2017-2018;

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe veçanërisht në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik. Ky vlerësim realizohet përmes përdorimit të metodologjive të ndryshme, si pyetësorë me studentët, fokus-grupet, raporte vetëvlerësimi të pedagogëve, etj..Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe shoqërohen me rekomandime për përmirësime të mundshme në të ardhmen [dok 29].

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

NJSBC dhe Departamenti i Inxhinierive janë njësitë bazë për monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë së programit të studimit. Rekomandimet që burojnë nga përgatitja e raporteve periodike zbatohen në program të studimit dhe reflektimi i tyre janë ndryshimet e vazhduara që bëhen në masën 20% në fillim të çdo viti akademik.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Institucioni ndërmerr në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik një raport semestral dhe një raport vjetor. Në këtë raport përfshihen edhe vlerësimet sipas formatit të vlerësimit për çdo pedagog të angazhuar në programin e studimit. Vetëvlerësimi konsiston në përmbushjen e qëllimit të lëndës, në masën e realizimit të programit, frekuentimi i studentëve, literarura e përdorur, formimi paraprak i studentëve lidhur me konceptet që trajton lenda, rezultatet e arritura etj. Të dhënat e mbledhura shërbejnë për vlerësimin e programit të studimit në tërësi nga departamenti. Nga të

dhenat e raportit vjetor 2017 – 2018 rezulton se programi ka përmbushur qëllimin e tij në masën mbi 90%. Në çdo fund viti akademik departamenti inxhinierisë përgatit edhe një RVB i cila konkludon të dhënat e mbledhura nga studentët, NJSBC dhe nga kontrollet periodike të kryera.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Rekomandimet e shprehura në raportin RVB dhe në analizen SWOT shërbejnë si bazë të përmirësimeve që kërkohen në drejtim të cilësisë. Evidentojmë që institucioni ka të ngritur një strukturë institucionale e cila funksionon në nivel poshtë – lart dhe është subjekt përmirësimi i vazhdueshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. 	<p>Pas shqyrtimit të RVB dokumentacionit përkatës dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC gjatë vizitës në institucion GVJ u konstatua se AU ka institucionalizuar praktikën e sigurimit të brendshme të cilësisë duke ngritur NJSBC. Kjo njësi, ndjek procesin e vlerësimit të cilësisë, duke matur ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi. Në këtë proces, NJSBC përdor metodologji të caktuar, me instrumente matëse dhe vlerësuese.</p> <p>Në procesin e vlerësimit të stafit përfshihet edhe Departamenti i Inxhinierive. Vlerësimi bëhet nëpërmjet instrumentave që përdor NJSBC dhe nga shefi i departamentit nëpërmjet kontrolleve dhe analizimit të të dhënave të mbledhura. NJSBC e përfshin këtë informacion në raporte semestrale dhe vjetore, ku përfshihen edhe të dhënat në % të kalueshmërisë dhe notat mesatare.</p> <p>Të dhënat e mbledhura konkretizohen në formatin e raportit vjetor të vlerësimit të brendshëm [dok.29 – raport vjetor 2016 – 2018;].</p>
<p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare; provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të 	<p>Në këtë raport jepen edhe rekomandimet sëbashku me një analize SWOT të mundësive dhe pengesave që departamenti i inxhinierive është përballur në vitin akademik.</p> <p>Raportet e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm publikohen në faqen web të Universitetit. Në këtë faqe gjenden gjithashtu dhe rezultatet që institucioni dhe secili nga departamentet synon të arrijë.</p>

- studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursit për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
 - g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
 - h. Etj.

Institucioni përdor metoda të tërthorta duke realizuar anketimin e studentëve në fund të çdo semestri në lidhje me:

- a. Përmbajtjen e lëndës
- b. Performancën e pedagogut të lëndës
- c. Frekuentimin e studentëve;
- d. Kalueshmeria në çdo lëndë të programit të studimit;
- e. Mendimi nga studentët.

Për semestrin e parë të vitit 2018 morren pjesë në anketim 15 studentë ose 46.95% nga viti i I-rë dhe 11 studentë ose 47.85% nga viti i II-të. 5% e studentëve dhe në intervistat focus-grup morrën pjesë 8 studentë [dok. 26-Raport semestral 2018].

Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta si:

- Matja e cilesisë për programin Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike nga shefi i departamentit të inxhinierive përmes kontrollit në bazë të një plan pune të vendosur në fillim semestri tek stafi PAK dhe PAE.
- Përdorimi i formatit të vetvlerësimit të punës së pedagogut i cili plotësohet nga stafi akademik në lidhje me zhvillimin e lëndës dhe masën e plotësimit të objektivave të saj;
- Dëgjimi në auditor
- Vlerësimi i pjesëmarrjes së studentit në orët e mësimi;
- Vlerësimi me notë dhe pikë;
- Vlerësimi i detyrave të realizuara nga studentit;
- Vlerësimi i orëve laboratorike;
- Mbrojtja e raportit në lidhje me praktikën profesionale;

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Institucioni përgatit në fund të çdo viti akademik një raport vlerësimi të brendshëm. Për vitin akademik 2017 – 2018 rezultojnë objektivat e përgjithshme të programit të studimit janë përmbushur. Në raportin për vitin akademik 2017-2018 vlerësimet e studentëve në Master mbeten më pozitive krahasuar me studentët në Bachelor.

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Studentët shfaqin më shumë interes në lëndët e fushave të tyre përkatëse, sesa nga lëndët e formimit bazë.

Ky raport është i aksesueshëm në faqen kryesore të universitetit në linkun <http://albanianuniversity.edu.al/ep-content/uploads/2017/04/Raporti-Vjetor->

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Nga takimi me përfaqesuesen e NJSBC dhe takimet me stafin akademik si dhe studentët, GVJ evidentoi se hartohen raporte vjetore në lidhje me ecurinë e programit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike [dok.25 dhe dok. 26].

AU ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike ne website.

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Albanian University është vlerësuar nga ekspertet e ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional duke kaluar pozitivisht akreditimin institucional shprehur me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017

AU ka ngritur NJSBC dhe në bazë të vendimit nr. 157/3 date 08.09.2016 të Senatit Akdemik është miratuar vendosja e përfaqësuesve të SC në nivel departamenti konkretisht nga dy pedagogë PAE. Evidentojmë nga të dhënat e mbledhura dhe dokumentacioni i dorëzuar që AU ndjek një politikë të qartë në lidhje me punën drejt përmirësimit të cilesisë dhe programit të studimit.

Politikat në lidhje me punën e NJSBC janë të shprehur në Rregulloren e Institucionit [neni 13 i saj], në Statut dhe në kontratat e punës së stafit akademik ku disa nga përgjegjësitë e tyre shprehin edhe detyrat e NJSBC në lidhje me matjen e performancës së mësimdhënies. Këto politka janë në pajtueshmëri me strategjinë afatgjatë të institucionit. Sigurimi i cilësisë bëhet në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat [dok 53, 54, 55, 56].

KPSC përdor mekanizma me synimin që të rritet ndërgjegjësimi për sigurimin e cilësisë. Personeli dhe studentët ftohen rregullisht të bëhen pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm për të garantuar cilësinë e programeve të studimeve. Në broshurën e programit të studimit shprehet gjithashtu rëndësia e cilësisë në mësimdhënie dhe sigurimit të saj.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në RVB, vizitën në institucion dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se:

- Politikat në lidhje me punën e NJSBC janë të shprehur në Rregulloren e Institucionit, në Statut dhe në kontratat e punës së stafit akademik
- NJSBC bashkëpunon me Departamentin e Inxhinierive për matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik.
- NJSBC në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierive organizon forma kontrolli, vlerësim të studentëve në fund të çdo semestri përmes pyetsorëve dhe fokus grupe tek studentët, përmes plotësimit të formatit të vlerësimit nga çdo pedagog, përmes kontrollit në orë leksioni dhe laboratorë.
- Raportet e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm publikohen në faqen Web të Universitetit.
- AU ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

GVJ konkludon:

Standardi I.10 – mendojmë se përmbushet

Standardi I.13- mendojmë se përmbushet

Standardi II.7- mendojmë se përmbushet

Standardi VIII.1- mendojmë se përmbushet

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion [**dok. 9 – objektivat e programit të studimit**] programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike ka për qëllim të realizojë përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit. Kjo përgatitje, gjatë periudhës tre vjeçare mbi nivelin “Bachelor“, ku merren bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara, u krijon mundësinë studentëve të marrin njohuri më të thelluara në fushën përkatëse. Ky thellim i njohurive ndihmon inxhinierët e rinj në një integrim më të lehtë në tregun e punës. Programi i studimit ka për qëllim të krijojë një profil të studentit të diplomuar, të aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

- aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme me sisteme elektronike të aplikuara dhe telekomunikacion,

- aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë e drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektronike apo projektimin dhe realizimin e sistemeve të telekomunikacionit
- pas një periudhe stazhi në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këtë fushë.

Programi i studimit në punën e tij për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit si edhe në vijim të politikës së përmirësimit të vazhdueshëm si rezultat i të dhënave të mbledhura nga vlerësimi periodik i tij institucional si edhe kërkesat e tregut të punës paraqet në vitin akademik 2017 – 2018 një strukturë të formuar. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur lidhur me përmirësimin në kurrikul evidentojmë një përmirësim të saj në masën 20%. Ky program ka qenë subjekt rishikimi edhe për vitin akademik 2016 – 2017.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit *Master i Shkencave* në “Inxhinieri Elektronike” është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 411, datë 25/08/2011. Në Maj 2017 ky program studimi kaloi akreditimin e parë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

- Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (A) plotësojnë **10 ECTS ose 8.33%** të programit,
- Disiplina të formimit karakterizues (B) plotësojnë **50 ECTS ose 41.67%**,
- Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese (C) plotësojnë **10 ECTS ose 8.33%**,
- Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët (D) plotësojnë **8 ECTS ose 6.67%**,
- Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktika apo stazhe (E) plotësojnë **12 ECTS ose 10.00%**,
- Përgatitja e tezës së diplomës (F) plotëson **30 ECTS ose 25.00%** të programit.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 9-11 orë në auditor dhe 14-16 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 8 orë në auditor dhe 17 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 15-16 orë në auditor dhe 9-10 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 15-16 orë në auditor dhe 9-10 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 3.5 orë në auditor dhe 21.5 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Për vitin akademik 2017 – 2018 evidentojmë një përmirësim të kurrikulës [dok. 52, 54, 55 dhe 56]. Këto ndryshime vijnë si pasojë e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, kërkesës së tregut të punës dhe rezultateve të vlerësimit të brendshëm të departamentit të inxhinierive.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij programi studimi është personel akademik me tituj/grada dhe rreth 81% e lëndëve mbulohen nga PAE.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset janë hartuar për çdo lëndë dhe përmbajnë këto elementë bazë:

- Përshkrimi I lëndës;
- Kompetencat që fitohen nëpërmjet lëndës;
- Tematika e lëndës e shprehur në orë dhe përshkrim për secilën prej tyre;
- Plani i orëve praktike i shpjeguar sipas tematikës, veprimtarisë dhe orëve përkatëse;
- Plani i orëve laboratorike i shpjeguar sipas tematikës, veprimtarisë dhe orëve përkatëse;
- Ngarkesa në autditor dhe jashtë saj;
- Metodologjia e mësimdhënies;
- Detyrimet e studentit për lëndën;
- Vlerësimi i ndarë sipas kategorive:
 - Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve – 5 pikë;
 - Dorëzimi i detyrave të kursit/projekt kursi- 5 pikë;
 - Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë – 10 pikë;
 - Provimi i ndërmjetëm/moduli – 20 pikë;
 - Provimi përfundimtar – 60 pikë;
- Literatura e detyruar;
- Literatura plotësuese;

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Referuar syllabuse të programit Master në Inxhinieri Elektronike, GVJ i shqyrtoi të gjitha syllabuset përkatëse të lëndëve të programit mësimor dhe rezulton se ato janë hartuar sipas formatit të kërkuar me elementët bazë të tyre [dok.10 dhe 11]. Syllabuset janë subjekt përmirësimi të vazhdueshëm. Për vitin akademik 2017 – 2018 ndryshime janë bërë në syllabuset për lëndët: “Teoria e frekuencave 1” në përputhje me kalimin e lëndës nga 6 ETCS në 5 ETCS; lënda “Antena dhe shpërndarja e valëve në hapësirë” – detajim të seminareve në përputhje me kalimin e lëndës nga 4 – 5 ETCS; Lënda “Sensorët dhe instrumentim procesesh” – detajim i temave kryesore me nëntemat;

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Ky program është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit, VBA nr. 36, datë 19.05.2017, për një kohëzgjatje një vjeçare.</p> <p>Ky program përfundon me diplomën Master i Shkencave dhe ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të dy vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë së paku 120 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike” ju ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara shkencore dhe profesionale në fushën e Inxhinierisë Elektronike përmes metodave, instrumenteve dhe teknikave inovative.</p> <p>Përvetësimi i këtyre aftësive bëhet i mundur në sajë të thellimit të njohurive, që studentët marrin në programet <i>Bachelor</i> në fushën e Inxhinierisë.</p> <p>Këto njohuri bazë thellohen më tej gjatë studimit në programet <i>Master i Shkencave</i> duke i zbatuar në planin metodologjik dhe aplikativ, në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të përballuar problematikat e ndryshme të fushës së studimit, projektimin dhe zhvillimin e impianteve dhe sistemeve elektronike, si dhe për të dhënë kontributin përkatës në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të këtij sektori [dok.12]. Gjithashtu në kuadër të këtij programi studimi, studentët thellojnë njohuritë e tyre në drejtimin e kërkimit shkencor dhe krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për të vazhduar më pas studimet e ciklit të tretë - doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të</p>	<p>Formimi teoriko-praktik në kuadër të “Masterit të Shkencave në Inxhinieri Elektronike” bën të mundur integrimin e shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës .</p>

justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Përmbajtja e programit të studimit si dhe organizimi i tij janë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen.

Përmes përmbushjes së objektivave specifike të programit studentët marrin njohuri teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre:

- a. për të zhvilluar veprimtarinë në institucione publike dhe private në kuadër të sistemeve elektronike të aplikuara dhe në telekomunikacion;
- b. për të zhvilluar veprimtarinë në mënyrë të drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të pajisjeve elektronike, si dhe projektimin dhe realizimin e sistemeve të telekomunikacionit;
- c. pas një periudhe praktike në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar kualifikimin edhe përgatitjen e teknikëve dhe profesionistëve të ardhshëm në këtë fushë.

Kontrolli i vazhdueshëm i studentëve dëshmon ecurinë dhe arritjet e tyre për ciklin përkatës të studimeve. Mënyrat e vlerësimit të studentëve dhe tutoriati i tyre janë të përcaktuar qartë në Rregulloren e Departamentit të Inxhinierisë. Numri i pakët i studentëve mundëson një bashkëveprim aktiv student /lektor e cila u theksua edhe në takimin me studentët përmes shembujve që ata sollën.

Mënyra e vlerësimit të studentëve është e shprehur edhe në syllabuse e cila varion në varësi të lëndës dhe mënyrës së organizimit të saj. Në disa prej tyre evidentojmë një vlerësim të provimeve të pjesshme, detyrave të kursit dhe seminareve, ndërsa në disa vëmendje i jepet projekteve të kursit.

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Ky program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikatat më të mira të vendeve europiane. Ai tenton të jetë konkurrues për nga elementët që përmban (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara.

Program i studimit është ndertuar mbi bazën e programeve të njëjta të Universiteteve Italiane, të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe janë bërë në vitë adoptimet dhe përshtatjet në përputhje me kërkesat e tregut dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Ky adaptim i praktikave Europiane e bën programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike konkurrues në tregun vendas dhe të huaj.

	Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me deklaratën e Bolonjës dhe kërkesat e tij, si dhe në përputhje me udhëzimet për Arsimin e Lartë në Shqipëri.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike synon në marrjen e njohurive teorike dhe praktike dhe në aftësimin sa më të mirë profesional të studentëve.</p> <p>Në lidhje me këtë disiplinë të formimit karakterizues plotësojnë (B) 50 ETCS ose 41.67% të programit të studimit dhe disiplinat formuese të ngjashme (C) ose integruese me disiplinat karakterizuese plotësojnë 10 ETCS ose 8.33% të tij. Në këtë program studimi 134 orë janë laboratorike ku synohet aftësimi praktik i njohurive teorike të marra në auditor.</p> <p>Sipas dokumentacionit, plani mësimor i programit të studimit Msc në Inxhinieri Elektronike parashikon zhvillimin e praktikë profesionale (6 ETCS).</p> <p>Gjithashtu në të përfshihen edhe disa të lëndë me karakter aplikativ. Në një pjesë të tyre janë parashikuar detyra/projekte kursi, në funksion të aftësimi profesional të studentëve.</p> <p>Programi i studimit është në përmirësim të vazhdueshëm për të qenë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të MASR.</p> <p>Personeli akademik është vazhdimisht i angazhuar në projekte kërkimore shkencore, pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe autor i parë ose bashkë-autor në artikuj të publikuar në revista shkencore.</p> <p>Kjo punë kërkimore evidentohet të reflektohet edhe në përmbajtjen e syllabuseve, përmirësimin e tyre në çdo vit akademik dhe në cilësinë e mësimdhënies.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/A
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</p>	<p>Departamenti i inxhinierive ka ndërmarrë për vitin akademik 2017 – 2018 një studim tregu. Grupi i punës u ngrit me vendim të Departamentit të Inxhinierive, në mbledhjen e departamentit, datë 23/06/2017 dhe mori miratim nga Dekanati në shkresën Nr. 227 Prot., datë 28/06/2017.</p> <p>Në përzgjedhjen e anëtarëve të grupit të punës janë patur parasysh kompetencat profesionale, mundësitë</p>

<p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, si dhe aftësitë analitike të tyre.</p> <p>Ky studim tregu konsiston ne:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Inkurajimin e studimeve në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (SHTIM) për tregun e punës; • Analiza e tregut të punës bazuar në të dhënat e INSTAT 2016, me fokus të veçantë në fushat inxhinierike • Pyetsore drejtuar kompanive private dhe bizneseve (17 të anketuar për inxhinieri elektronike); • Pyetsore drejtuar studentëve (12 studentë të anketuar). <p>Në këtë studim 69% e studentëve pranojnë se pozicioni i tyre i punës kërkon marrjen e një titulli më të lartë studimi. Bashkepunimi i kompanive të biznesit me IAL duhet të jete më aktiv.</p> <p>Dy veprimet kryesore që duhet të ndërmarre IAL-ja për të përmirësuar punësimin e të diplomuarve të tyre, sipas bizneseve të intervistuar janë</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zhvillojnë kurse studimi më të përshtatshme për nevojat e punëdhënësve - 35.29%, “të përfshijnë eksperiencë praktike në kurset e studimit” - 29.41%. - Perthithja e mendimit të tyre nga ana e IAL duhet të jetë më e madhe. (vetem 18.18% e tyre pranuan se u është kërkuar mendimi ndërsa 45.45% asnjëherë) <p>GVJ e vlereson punën e bërë në lidhje me format e studimit të tregut të punës. Evidentojmë përpjekje pozitive në këtë drejtim, rekomandojmë të përmirësohen në të ardhmen përmes analizave sasiore dhe cilësore të treguesve kryesore të tregut të punës dhe me impakt në programin e studimit.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>AU ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesin kombëtar, dhe synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin “Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike” është 2 vite i organizuar në 4 semestra, forma e studimit është studime me kohë të plotë dhe studentët për t’u diplomuar duhet të realizojnë 120 kredite ECTS.</p> <p>Në planin mësimor të këtij programi studimi parashikohet që studenti në përfundim të studimeve duhet të realizojë një tezë diplome e cila vlerësohet</p>

	me 30 kredite.
--	----------------

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;

Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Departamenti i Inxhinierive jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimeve. Ndertimi i programit të studimit është i shprehur në Rregulloren e programit [dok.12]. Në fillim të vitit akademik stafi akademik përmirëson syllabuset dhe modulet e lëndëve dhe i vë në dispozicion të studentëve. Detyrat dhe përgjegjësitë e studentit jepen në Rregulloren e FAE dhe të Programit të studimit. Format e vlerësimit janë të shprehur në Rregullore dhe në syllabus. Studenti informohet në fillim të çdo lënde lidhur me kërkesat. Këto vihen në dispozicion në formë elektronike ose hard copy. [dok. 13 neni 36]

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Procesi i diplomimit është i shprehur qartë në Statut, në Rregulloren e FAE dhe në Rregulloren e Programit të studimit [dok 13 – neni 31, 32 33 dhe 34]. Bazuar në VKM 41 datë 24.01.2018, me rishikimin e kurrikulës, tema e diplomes do të jetë 18 kredite.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Programi i studimit është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit, VBA nr. 36, datë 19.05.2017, për një kohëzgjatje një vjeçare.
- Programi i studimit Msc. Inxhinieri Elektronike realizohet me 120 kredite europiane ECTS me kohezgjatje dy – vjeçare.
- Departamenti i Inxhinierive jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit
- Ndertimi i programit të studimit është i shprehur në Rregulloren e programit.
- Përmbajtja e programit të studimit dhe organizimi i tij janë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen.
- Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Elektronike është hartuar duke u mbështetur në përvojat brenda dhe jashtë vendit.
- Programi i studimit është në përmirësim të vazhdueshëm për të qenë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të MASR
- Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike synon të jetë në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

GVJ konkludon:

Standardi I.1– mendojmë se përmbushet

Standardi I.2– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.4– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.5– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.6– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.7– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.8– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.9– mendojmë se **përmbushet**
Standardi I.12– mendojmë se **përmbushet**
Standardi II.6– mendojmë se **përmbushet**
Standardi II.8– mendojmë se **përmbushet**

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta, ngarkesa javore nuk duhet të kalojë 25 orë/javë. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore.

Format e mesimdhënies:

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët/ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit, projekte, etj. të organizuara në module. Numri total i veprimtarive formuese është 14, ku janë parashikuar 12 provime, praktika dhe teza e diplomës. Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore. Programi mësimor është i ndërtuar nga 3000 orë studimi në total, nga të cilat 1075 janë orë studimi në auditor dhe 1925 janë orë studimi individual [dok.125].

Puna mësimore organizohet në bazë grupi, kursi dhe nëngrupi. Leksionet zhvillohen në bazë kursi, ushtrimet dhe seminarët zhvillohen në bazë grupi mësimor dhe punët laboratorike, në bazë nëngrupi mësimor. Ndarja e studentëve në grupe fiksohet në regjistrat vjetorë të cilët janë dokumente zyrtarë ku evidentohet zhvillimi i orëve të mësimi nga pedagogët dhe frekuentimi i tyre nga studentët.

Regjistri i grupit është një dokument zyrtar që vërteton frekuentimin dhe që i kushtëzon studentit të drejtën e dhënies së provimit.

Frekuentimi:

Frekuentimi i leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve në të paktën 75 % të seancave është i detyrueshëm, si rregull, për sigurimin e krediteve dhe lejimin për t'u provuar në lëndën përkatëse. Frekuentimi në punët laboratorike dhe projektet në 100 % të seancave është i detyrueshëm, si rregull.

Për studentët që kanë munguar me arsye në jo më shumë se 25 % të seancave të rregullta të punëve laboratorike planifikohen deri në dy seanca plotësuese për çdo semestër dhe lëndë.

Provimet [dok.12 –Rregullore e Programit të studimit, neni 20, neni 21]:

Gjatë vitit të parë akademik organizohen tre sesione provimesh. Në vitin e dytë akademik organizohen pesë sesione provimesh të përcaktuara në kalendarin akademik të çdo programi mësimor dhe tre sesione diplomimi. Me vendim të Senatit, Fakultetet kanë të drejtë të organizojnë edhe sesione të tjera të kufizuara të provimeve të mbartura (riprovime), jashtë kalendarit akademik, para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë. Në këto provime studentët lejohen kundrejt pagesës përkatëse. Kalendarin akademik i çdo programi studimi miratohet nga Dekani . Kontrolli i dijes bëhet me gojë, me shkrim, me detyra kursi/projekt kursi ose me shkrim dhe me gojë. Kjo vlen si për provimet ashtu edhe për testimet apo seancat e kontrollit që mund të organizohen gjatë semestrit ose gjatë vitit.

Korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit .

Vlerësimi [dok.12 –Rregullore e Programit të studimit, neni 23]:

Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

1. Provimi përfundimtar 60 pikë (60%)
2. Provimi të ndërmjetëm 20 pikë (20%)
3. Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%).

Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare/ushtrime, testim përgjatë semestrit, laboratore, detyra ose projekte kursi etj.), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm, në kuptimin që përfundimi i një vlerësimi duhet të shprehet detyrimisht edhe me notë. Notat kaluese konsiderohen nga 5 e lart, pikët nga 41 e lart dhe shkronjat nga A deri E.

Praktikat mësimore: Praktikat mësimore zhvillohen, brenda afatit të caktuar në kalendarin akademik, në institucionet me të cilat Albanian University ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga Departamenti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm [dok.12 –Rregullore e Programit të studimit, neni 28]::

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione – 559 orë
- Seminare- 4 orë
- Ushtrime - 273 orë
- Laboratore- 134 orë
- Detyre kursi - 5 orë
- Praktikë profesionale- 0 orë
- Tema e diplomes - 100 orë

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit dhe vlerësimit të studentëve bëhen në përputhje me ndërtimin e lëndës. Evidentojme tre forma kontrolli të dhëna si më poshtë vijon:

Lëndët me leksione/seminare/laboratorë/detyrë kursi

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në pikë) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5
Dorëzimi i detyrave të kursit	5
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10
Provimi i ndërmjetën/ moduli	20
Provimi përfundimtar	60
Në total	100

Lëndët me leksione/seminare

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa në pikë ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	10
Dorëzimi i detyrave të kursit	10
Provimi i ndërmjetën/ moduli	20
Provimi përfundimtar	60
Në total	100

Lëndët me leksione/seminare/laboratorë

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në pikë) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5
Dorëzimi i detyrave	5
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10
Provimi i ndërmjetën/ moduli	20
Provimi përfundimtar	60
Në total	100

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktivizimi i studentëve është synimi kryesor në këtë program studimi. Takimi me studentët evidentoi një pjesëmarrje aktive të tyre në orët laboratorike, në mbrojtjen e raportit të praktikës profesionale, punimit dhe mbrojtjen e temës së diplomës. Aktivizimi i tyre shprehet në pjesëmarrjen në konferenca studentore që institucioni organizon ku ata referojnë bashkëpunime me pedagogët përkatës.

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi mësimor, Master i Shkencave në Inxhinieri Eletronike, zgjat 2 vite akademike, i organizuar në katër semestra me një total prej 120 ECTS. Veprimtaritë mësimore në auditor zhvillohen për një total prej 20/25 orësh në javë. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe frekuentimi i aktiviteteve formuese në auditor është i detyrueshëm në masën 75%.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ evidentoi se në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 55 studentë, me notë mesatare të programit *Bachelor* të përfunduar 6.43.

Në vitin akademik 2017 – 2018, në programin e studimit *Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”* janë regjistruar:

Në vitin e parë janë të regjistruar 32 studentë, me kalueshmëri 75.2% dhe notë mesatare 6.48.

Në vitin e dytë janë të regjistruar 23 studentë, me kalueshmëri 100% dhe notë mesatare 5.9.

Numri total i të diplomuarve në programin e studimit *Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”* për vitin akademik 2016 – 2017 është **15 studentë** (13 në sezonin e verës dhe 2 studentë në sezonin e vjeshtës) dhe për vitin akademik 2017-2018 është **24 studentë në sezonin e verës**.

AU ndjek një politikë të qartë në lidhje me transferimet e studentëve. AU ka ngritur edhe Zyrën e Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve e cila funksionon mbi bazën e një Rregullore e *Trasferimeve*, bzuar në Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në fuqi si dhe në Statutin (neni 61) dhe Rregullore e Brëndshme të “Albanian University” (neni 50) [dok.7]. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik në Fakultete të ndryshme brenda AU si edhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në AU. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, përcaktimi i vitit akademik në të cilin transferohet në varësi të përputhjes me programin e studimeve miratuar dhe zbatuar nga Fakulteti, merret nga Komisioni i Ekuivalentimeve, i cili ngrihet nga Dekani dhe i cili përbëhet nga 3 deri në 5 pedagogë të brëndshëm të fakultetit. Modalitetet e transferimeve disiplinohen në Rregullore e Transferimeve të studentëve [dok. 13-Rregullore e FSHA, neni 29, dok. 31 –Rregullore e Transferimeve].

Kufizime shfaqen për transferimet e studimeve nga shkollat profesionale dhe universitetet e rretheve, për shkak të mospërputhjes në masën 60% të programeve të lëndëve. Për vitin akademik 2017 – 2018

rezultojnë 4 studentë të transferuar në vitin e parë dhe 23 studentë në vitin e dytë. Numri i madh i studentëve të transferuar në vitin e dytë vjen si pasojë e mbylljes së programit MSc. në Mekatronikë dhe transferimi i tyre në këtë program studimi. Në sekretarinë mësimore grupit u vunë në dispozicion disa dosje studentesh të përzgjedhur në mënyre rastësore. Grupi konstatoi se sekretaria mësimore disponon një dokumentaëion të plotë ,konform rregulloreve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloret e Institucionet dhe në pëpruthje me standartet dhe aktet ligjore në fuqi [vizitë në sekretarinë mësimore]. U verifikuan dosjet e studentëve të zgjedhur në mënyre rastësore të cilat u gjetën konform rregullave dhe kriterëve të regjistrimit konkretisht:

1. Albert Celmanaj (transferuar nga dega Mekatronike në vit të II):

1. Fotokopje të ID;
2. Diplome e shkollës së mesme
3. Diplomë dhe listë notash për nivelin Baëhelor për inxhinieri Elektrike;
4. Formular aplikimi;
5. Kontratë studenti;
6. Vërtetim ç' regjistrimi;
7. Vlerësim të ekuivalentimit të lëndëve nga komisioni i posaçëm;
8. Vërtetim i gjuhës së huaj (TOEİË);
9. Mandat pagesë;

2. Juliana Kurti (regjistrua per here te pare)

- a) Fotokopje e ID;
- b) Diplomë e shkollës së mesme origjinale;
- c) Diplomë Baëhelor ne AU;
- d) Vlerësim për njohje të diplomes që ka mbaruar në Inxhinierine elektrike në AU;
- e) Kontrate studenti;
- f) Formular aplikimi;
- g) Foto
- h) Mandat pagesë;

3. Gerti Rrudha (regjistruar për herë të parë)

- a) Fotokopje e ID;
- b) Njohje të gjuhes angleze APTIS
- c) Vërtetim i programit Baëhelor në Inxhinieri kompjuterike dhe listë notash;
- d) Njohje e vlerësimit të programit të Inxhinierisë Kompjuterike;
- e) Diplome e shkollës së mesme;
- f) Formular aplikimi;
- g) Kontrate studneti;
- h) Foto;
- i) Mandat pagesë;

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi i studentëve në programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike bëhet me konkurrim në rast se numri i kërkesave është më i madh se kuota e pranimit. Kandidati për ndjekjen e studimeve Master paraqitet personalisht pranë Zyrës së Regjistrimit ku plotëson formularin e aplikimit për këtë program të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Procesi i seleksionimit organizohet dhe drejtohet sipas rregullores së organizimit të programit të studimit Master dhe sipas vendimeve të autoriteteve

drejtuese të këtij program studimi. Procedurat e pranimit të studentëve janë të shprehur në Rregulloren e Programit të studimit [dok. 13, neni 9].

Kriteret e regjistrimit në këtë program studimi janë:

1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve *Bachelor* në përputhje me fushën e studimit ku ka grumbulluar 180 kredite ECTS.
2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë.
3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore.

Në rast se studenti ka përfunduar një diplomë tjetër jashtë disiplinës së përcaktuar më lart atëherë Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimeve të programeve i ngritur nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vlerëson aplikimin duke patur në konsideratë këto kriteret:

- Diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme të paktën në masën 60% me programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike,
- Dosjen e kandidatit,
- Motivimin e tij për të ndjekur programin e studimit të kërkuar.

Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në ciklin e II-të të studimeve, në Albanian University është me dosje.

Punësimi i studentëve:

Zyra e Karrierës dhe Alumnit mbledh të dhëna përmes kontakteve telefonike dhe komunikimit me e-mail me të diplomuarit. Rezulton se për vitin akademik 2016-2017 numri i të punësuarve është 4 studentë në përputhje me diplomën ose 26.6% e të diplomuarve, dhe 15.4% (vetëm 2 studentë) rezultojnë të punësuar jo në përputhje me diplomën. Për vitin akademik 2016-2017 rezultojnë të papunë 78.6% shifër kjo e lartë por që mendojmë se realisht nuk shpreh papunësinë por ka lidhje me menyrën e marrjes së informacionit nga zyra e karrierës & alumni. Për vitin akademik 2017-2018 evidentojmë një rritje. Konkretisht për këtë vit numri i studentëve të punësuar është 14 ose 41.7% dhe 25% (6 studentë) janë punësuar jo në përputhje me diplomën.

Rekomandojmë që: Zyra e Karrierës & Alumni duhet të përmirësojë format dhe instrumentat për mbledhjen e të dhënave në lidhje me punësimin e studentëve në fund të studimeve të tyre. Saktësia e informacionit është indikator i cilesisë së mësimdhënies dhe në tërësi e programit të studimit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Lista e studentëve të punësuar për vitin akademik 2017 – 2018;

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ëiklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ëiklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkenëve” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Baëhelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite EËTS;	Studentët që ndjekin studimet në programin e studimit MSc. Inxhinieri Elektronike plotësojnë kushtet e vendosura nga institucioni në Statut, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe në Rregulloren e Programit të studimit.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar	

<p>dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përrëaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkençave” dhe programet e integruara të studimeve të ëiklit të dytë niveli i gjuhës angleze është E1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Këto kritere pranimi janë në përputhje me aktet ligjore të vendosura nga MASR. Kriteret e përgjithshme konsistojnë në zotërimin e një diplomë “Bachelor” dhe të ketë grumbulluar 180 kredite ETCS. Në takimet në institucion, evidentuam që institucioni zbaton me korrektësi procedurat e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Konstatojme zbatimin e nje procedurë të qartë në lidhje me transferimet e kryera. Në dosjet e studentëve (përkatesisht në mënyrë rastësore 3 prej tyre u verifikuan) gjetëm rezultatet e Komisionin adhoc të ekuivalentimit të lëndëve dhe konkluzionet përkatëse të tyre (minimalisht sipas kriterëve duhet të jetë 60% në përputhshmëri me programin e studimit). Të gjithë dosjet kishin certifikatën e nivelit B1 në anglisht (APTIS ose TOEIC). Konstatuam se si pasojë e mbylljes së programit të Mekatronikës, shume studentë kanë transferuar studimet e tyre në këtë program studimi. Institucioni është në përpjekje të vazhdueshme për hartimin e kriterëve të pranimit të studentëve në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Institucioni zbaton një politikë të qartë informuese në lidhje me programet e studimit tek studentët dhe mundësitë për punësim të tyre. Në Statut janë përcaktuar qartë edhe organet të cilat merren me orientimin e studentëve gjatë studimit dhe në tregun e punës. Aktualisht në Universitetin “Albanian University” është e ngritur Zyra e Orientimit dhe Këshillimit të studentëve dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së studentëve(ZKMS). Të dyja këto zyra në bashkëpunim me departamentin e inxhinierive informojnë studentët në lidhje me programin e studimit, përmbajtjen, licensimin e tij, akreditimin dhe mundësinë për punësim. Departamenti i Inxhinierive informon studentët në lidhje me programin e studimit dhe jep të dhëna të detajuar që në momentin e regjistrimit të tyre në programin e studimit Msc në Inxhinieri</p>

Handwritten signatures and initials.

Elektronike.

Institucioni përdor forma të ndryshme për informim të studentëve:

1. Website
2. Përmes broshurave
3. Përmes stafit akademik që në fillim të zhvillimit të modulit/lëndës;

Zyra e Karrierës and Alumni në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në fillim të vitit të parë organizojnë edhe leksion të hapur e cila quhet edhe “Java e Orientimit”, ku u shpërndahet studentëve “Manuali i Studentit” [takim me zyrën e Karrierës dhe Alumni].

Vlen të përmendet një larmi aktiviteteve të ndërmarra nga këto dy zyra në drejtim të:

Aktiviteteteve Orientuese

- Të drejatat dhe detyrimet e studentit ne Albanian University – 23 Tetor 2017
- Të njohim veprimtarinë e klubeve studentore – 22 Nëntor 2018
- Dita e informimit mbi programet e studimit Master të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive – 01 Qershor 2018

Të keshillimit dhe karrierës:

- Planifikimi i Karrierës – 06 Mars 2017
- Përgatitja e CV-së dhe letrës motivuese për punësim – 13 Mars 2017
- Teknikat e përgatitjes për një intervistë pune – 27 mars 2017
- Panair Karriere “Pritshmëritë dhe barrierat e tregut të punësimit sot” – 24 Qershor 2017;

Kjo zyrë mban kontakte me studentët e diplomuar. 6 muaj pas diplomimit kjo zyrë kontakton me studentët dhe merr informacion në lidhje me punësimin e tyre. Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe paraqiten në raportin e NJSBc. Të dhënat jepen në fund të semestrit të parë dhe në fund të semestrit të dytë.

Rekomandojmë që: kjo zyrë duhet të përmirësojë format e mbledhjes së informacionit në lidhje me punësimin e studentëve.

Standardi IV. 3- Instituëioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ëiklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ëiklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Instituëioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ëiklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ëiklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Instituëion disponon të dhëna për eëurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Departamenti i Inxhinierive përmes Sekretarisë Mësimore disponon të dhëna lidhur me numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, numrin e studentëve në hyrje. Vizita në sekretarinë mësimore evidentoi procedurën e regjistrimit, mbajtjes së të dhënave dhe procedurën e transferimit. Sekretaria mësimore në bashkëpunim me departamentin e inxhinierise mban të dhëna në lidhje m progresin e studentëve gjate studimit në këtë program deri në diplomim të tyre. U verifikuan të dhënat në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, dhe në Regjistrimin e Diplomave.

Këto të dhëna pasqyrohen edhe në raportet vjetore të vlerësimit të programit mësimor.

Standardi IV. 4- Instituëioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ëiklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ëiklit të dytë.

Kriteri 1 Instituëioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ëiklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ëiklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Instituëioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ëiklet e tjera të studimeve etj.

Zyra e Karrieres & Alumni ka një database ku mbahen të dhënat në lidhje me numrin e studentëve të punësuar.

Kjo zyrë mban kontaktet dhe rifreskon të dhënat e tyre 6 muaj pas diplomimit të tyre. Të dhenat ruhen në formë elektronike.

Në fund të vitit kjo zyre pasqyron të dhënat në raportin e NJSBC dhe ne raportin e vlerësimit të brendshëm të departamentit të inxhinierive [takim me zyren e karrieres & alumni].

Departamenti i inxhinierise me mbështetjen e ZKA orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilën do të zhvillojnë praktikën mësimore. Praktikrat mësimore zhvillohen në institucionet me të cilat Albanian University ka marrëveshje bashkëpunimi.

Standardi IV. 5- Instituëioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Në AU janë ngritur dhe funksionojne Zyra e Orientimit dhe Këshillimit të studentëve dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve (ZKMS).

Të dyja këto zyra në bashkëpunim me

<p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>departamentin e inxhinierive informojnë studentët në lidhje me programin e studimit, përmbajtjen, licensimin e tij, akreditimin dhe mundësinë për punësim. Per programin e studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike studentët informohen që në “Open days” ku drejtues të departamentit të inxhinierisë japin informacion në lidhje me programin e studimit [dok.99-aktivitete në kuadër të informimit].</p> <p>Informacion studentët marrin edhe përmes broshurave dhe website [dok.broshura]. Sekretaria mësimore luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e tyre në lidhje me praktikën e regjistrimit për studentët që regjistrohen për herë të parë ose transferohen. Studenti që në fillim informohet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tij. Në fillim të çdo lënde studentit njihet nga ana e stafit akademik me kriteret e vlerësimit. Rezultatet e provimit jepen në sekretarinë mësimore.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë dhe sekretaria mesimore informojnë studentët në lidhje me rezultatet e provimeve. Për vlerësimin e studentëve ndiqet një procedurë e qartë e dhënë në Rregulloren e FAE dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Në takimin me studentët konstatuam njohje nga ana e tyre edhe të procedurës së apelimit.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek eëurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me proësin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Koordinimit dhe Mbeshtetjes së Studentëve në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierive ndihmojnë studentët në zgjidhjen e problematikave që ata përballen gjatë vitit akademik. Raste u sollën në takim me studentët dhe me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe Mbeshtetjes së Studentëve.</p> <p>Procesi i tutoriatit funksionon në këtë</p>
	<p>program studimi. Numri i paket i studentëve mundëson një komunikim të hapur në cdo kohë me stafin akademik dhe vecanërisht me supervizorin e temës së diplomës.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive disponon një baze të dhënash në lidhje me kompanitë ku kryhet edhe praktika profesionale. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje</p>

bashkëpunimi me 22 kompani për vitin akademik 2017 – 2018 [dok.108-Lista e marreveshjeve per praktikat profesionale] ndonëse në takimin me stafin akademik u shpreh edhe marrëdhënia e paqëndrueshme me institucionet pranë të cilave zhvillohen këto praktika mësimore [takim me stafin akademik].

Konkluzionet e vlerësimit:

- Programi i studimit MSc. në Inxhinieri Elektronike ndjek kritere te qarta pranimi të cilat jepen në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në Rregulloren e programit te studimit.
- Studentët informohen ne lidhje me përmbajtjen e programit te studimit, cilësinë, akreditimin e tij.
- Zyra e Karrierës & Alumni në bashkepunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve informon ata në lidhje me mundësitë për punësim. Evidentojmë mbajtjen e një database në lidhje me studentët e diplomuar dhe të punësuar, *ndonësë rekomandojmë përmirësimin e metodave të mbledhjes së informacionit të cilin e konsiderojmë të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit.*
- Zyra e Sekretarisë është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me progresin e studentëve përgjate studimit të tyre në këtë program.
- Takimi me stafin akademik dhe me përfaqesues të departamentit të inxhinierive evidentoit marrëdhënia e paqëndrueshme me institucionet ku kryhen edhe praktikat profesionale.

GVJ konkludon:

Standardi IV.1– mendojmë se përmbushet
Standardi IV. 2– mendojmë se përmbushet
Standardi IV. 3– mendojmë se përmbushet
Standardi IV. 4– mendojmë se përmbushet
Standardi IV. 5– mendojmë se përmbushet
Standardi IV. 6– mendojmë se përmbushet

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

AU ka të shprehur qartë ne Statut synimin e saj në lidhje me kërkimin shkencor [dok.67 neni1]. Në misionin e tij AU synon në:

- a. Zhvillimin e një punë shkencore në të gjithë fushat që mbulon dhe përgatitjen e specialistëve dhe shkencëtarëve të rinj;
- b. Realizimin e kerkimit shkencor dhe veprimtaritë krijuese lidhur me të.

AU ndër objektivat strategjikë të saj në drejtim të përmbushjes së misionit ka edhe kërkimin shkencor [dok. 41 – strategjia e zhvillimit 2017 – 2022]. Institucioni ka ngritur edhe Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, Zyrën e Projekteve si edhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin në Senatën Akademik në zbatim të nenit 46 të Ligjit Nr.80/2015 [dok.67].

Në objektivat afatmesëm të AU-se është konsolidimi dhe forcimi i këtyre strukturave në mbështetje të kërkimit shkencor në Universitet [dok. 41 – strategjia e zhvillimit 2017 – 2022].

Departamenti i Inxhinierive bashkërendon punën e tij kërkimore shkencore në përputhje me politikën institucionale të Universitetit. Në strategjinë afatshkurtër 2017-2018 ky departament synon në rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes rritjes së projekteve dhe bashkepunimeve shkencore, bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe ndërkombëtarizimin e programit të studimit. Gjatë vitit 2017 – 2018 evidentohen përpjekje në drejtim të kërkimit shkencor. Të parë në tre akspete të rëndësishme: aktivitete shkencore në kuadër të institucionit, të stafit akademik dhe në kuadër të pjesëmarrjes së studentëve evidendojmë fakte të rëndësishme si më poshtë vijon:

Projekte kërkimore shkencore në kuader të veprimtarisë së departamentit të inxhinierive.

- a) Erasmus+ me Universitetin e Salernos, nga e cila kanë përfituar mobilitet 1 pedagog dhe 3 studentë. Është aplikuar sërish në Erasmus+2018 me Universitetin e Kamerinos, Itali dhe së fundmi është marrë përgjigje pozitive në këtë kuadër.
- b) Është aplikuar me një projekt në programin ËBF me partnerë Kolegjin “Pjetër Budi”, Kosovë dhe Universitetin e Teknologjisë dhe Shkencës së Informacionit “St. Paul the Apostle”, Maqedoni, me përgjigje jo pozitive .
- c) Është nënshkruar një marrëveshje me rrjetin italian NetC0, me të cilin janë programuar një sërë aktivitete akademike dhe kërkimore shkencore. Aktiviteti i parë në kuadër të kësaj marrëveshjeje është Ëorkshopi me temë “Zero Energy Living and Mobility for a Clean-Secure-Efficient Albania” gjatë Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEË 2018, zhvilluar në 18/06/2018.
- d) Në Shtator 2018, Departamenti është i angazhuar në organizimin e Konferencës së 14të Ndërkombëtare “Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries’ Collaboration”, duke qenë edhe organizatori kryesor së bashku me Organizatën Shqiptare për Cilësinë - AOQ [Evidencë 1.4].
- e) Institucioni bashkëpunon me organizatën zvicerane Swiss EP dhe po punon në drejtim të ngritjes së një inkubatori të teknologjisë, për t’i dhënë mundësinë studentëve të talentuar për të realizuar idetë e tyre në realizimin e produkteve teknologjike.

Puna shkencore e stafit akademik

Departamenti i Inxhinierive ndjek punën shkencore të stafit akademik. Bazuar në nenin 42 “Detyrimi dhe promovimi akademik shkencor” në Statut, personeli akademik në fillim të çdo viti akademik paraqet në Departament planin e veprimtarisë së tij shkencore – botimeve për tekste, monografi,

planin e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe në fund të vitit akademik paraqet edhe një raport të përmbushjes së objektivave. Institucioni përdor instrumenta për nxitjen e kërkimit shkencor nga ana e stafit akademik.

Vendimi i Senatit Akademik date 13.11.2017 për dhënie mbështetje financiare të stafit akademik në një konferencë apo botim në një revistë shkencore dëshmon për vullnetin pozitiv të institucionit në drejtim të aftësimit të stafit akademik përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në aktivitete shkencore. Shumë prej projekteve kërkimore të listuara ne aneks kanë shërbyer për të rritur mobilitetin e stafit akademik. Vlen të përmendet:

c. Nga bashkëpunimi me organizatën zvicerane Sëiss EP janë mundësuar një sërë leksionesh të hapura dhe trajnimesh për studentët, si dhe pjesëmarrja e koordinatorës së Qendrës së Sipërmarrjes Inxhinierike (ETEC) në *Peer Exchange Meetup*, Zvicër 04 – 08/6/2018 (<http://ëëë.peerexchange.org/speaker/genta-rexha/>)

d. Konferenca e IV Ndërkombëtare “*Problems and Challenges of Transformation of the Society toëards Standards of the European Union Conference*” organizuar në 22 dhjetor 2017 nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, Universitetin Bujqësor dhe Universiteti La Sapienza, Romë mundesoi pjesëmarrjen e 10 pedagogë nga Departamenti i Inxhinierive me 9 punime dhe 1 student me punimin e tij;

c. Pedagogë moderatorë në Workshopin me temë “Zero Energy Living and Mobility for a Clean-Secure-Efficient Albania”, 2018;

d.5 pedagogë mentorë në Konferencën e IV Studentore 2018;

f. Numri I botimeve të stafit akademik është I konsiderueshëm. Të dhënat jepen në tabelat në aneks të këtij raporti. Evidentoj pjesëmarrje aktive të stafit akademik në konferencat e organizuara nga institucioni dhe shumë pak në ato ndërkombëtare . Bazuar në raportin e vlerësimit për vitin akademik 2017-2018, për kerkimin shkencor rezultojne pjesëmarrje nga stafi PAE ne 24 konference ndersa numri I artikujve të botuar është vetëm 2. Nuk ka botime ne monografi, tekste shkollore.

3.Pjesemarrja e studentëve në aktivitete shkencore

a. Konferenca e IV Studentore 2018, Konferenca e IV Ndërkombëtare “*Problems and Challenges of Transformation of the Society toëards Standards of the European Union Conference*”, 2017;

b. Workshopi me temë “Zero Energy Living and Mobility for a Clean-Secure-Efficient Albania”, 2018;

c. Studentë pjesëmarrës në Konferencën e IV Studentore, 2018;

D. Konstatojme një pjesëmarrje aktive të studentëve në aktivitete ekstra-kurrikulare ndonësë të dhënat nuk jane shumë të qarta në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve të nivelit Master në to [dok. 88 – raporti 2017-2018].

Një kontribut në drejtim të publikimit të rezultateve të kërkimit shkencor luan dhe revista shkencore OPTIME [<https://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/>] si organ shkencor i AU, konceptuar dhe realizuar si tribunë e mendimit akademik për tema e probleme të teorisë dhe të praktikës së mësimdhënies, si hapësirë e domosdoshme për publikimin e punimeve studimore shkencore, drejtuar e realizuar nga organizmat akademike.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Aktivitete të planifikuara dhe në rang departamenti

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Të dhënat nga dokumentacioni dhe takimi me stafin akademik dëshmojnë për punën që ky staf kryen në lidhje me rritjen e aftësisë së tij profesional përmes kërkimit shkencor. Numri i botimeve dhe pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca është i kënaqshëm <i>Ndonëse rekomandojmë: një rritje të tij në revista me faktor impakti dhe në konferenca nderkombëtare jashtë vendit.</i></p> <p>Nga ana tjetër konsiderojmë që ngarkesa mësimore e stafit akademik është e lartë dhe rekomandojmë që lehtësimi i tij do të sjellë edhe një rritje më të madhe në lidhje me pjesëmarrjen e tij në konferenca dhe botime shkencore.</p> <p>Institucioni ndjek dhe monitoron punën kërkimore të stafit akademik bazuar në nenin 42 në Statut. Në fund të çdo viti akademik bëhet vlerësimi i punës shkencore të tij përmes numrit të botimeve në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca. Kjo reflektohet edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm vjetor të Departamentit të Inxhinierive.</p> <p>Institucioni përdor edhe mekanizma nxitës në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete shkencore. Vendimi i Senatit Akademik dëshmon për përdorimin e instrumentave nxitës në këtë drejtim.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi i studimit MSc. Inxhinieri Elektronike ofrohet në gjuhën shqipe. Ndonëse ofrohet në këtë gjuhë, stafi akademik është njohës i mirë i gjuhëve të huaja të fituara përmes specializimeve dhe doktraturave në Itali dhe në vende të tjera.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni organizon workshop dhe konferenca që mundësojnë aftësimin profesional të stafit akademik.</p> <p>Në objektivat afatshkurtra parashikon hapjen e kurseve profesionale “Mbi standardet ndërkombëtare dhe europiane mbi sisteme të ndryshme menaxhimi” .</p> <p>Institucioni ofron lehtësira dhe hapësira për personelin akademik të interesuar në zhvillimin e kualifikimeve të mëtejshme</p>

	brenda dhe jashtë vendit.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Zyren e Koordinimit dhe Botimeve Akademike e cila koordinon punën me problematikat e departamenteve. Revista "Optime" e cila botohet dy herë në vit shërben si një mjet ku stafi akademik mund të paraqesë botimet e tij.</p> <p>Kjo zyrë në bashkëpunim me departamentin e inxhinierivë koordinon dhe monitoron punën shkencore të stafit akademik dhe të departamentit në tërësi. Në lidhje me projektet shkencore në këtë zyrë punon një specialiste e veçantë e cila në fokus të punës së saj ka përgatitjen e projekteve kërkimore shkencore. Rezultatet e projekteve ruhen në një database. Kjo zyrë në bashkëpunim me departamentin e inxhinierive mban të dhëna në lidhje me mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Monitorimi dhe progresi shkencor i stafit akademik matet edhe përmes hartimit të një plani kalendarik aktiviteteve dhe vlerësimi i plotësimit të tyre në fund të vitit.</p> <p>Të dhënat reflektohen edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm të Departamentit të Inxhinierive.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Institucioni ndjek dhe monitoron punën kërkimore të stafit akademik. Për këtë bëhet në fund të çdo viti akademik edhe vlerësimi i punës shkencore të tij përmes numrit të botimeve në revista shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca.</p> <p>Institucioni përdor edhe mekanizma nxitës në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete shkencore. <i>Ndonëse rekomandojmë: një rritje të tij në revista me faktor impakti dhe në konferenca nderkombëtare jashtë vendit.</i></p> <p>Institucioni ka ngritur edhe Zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, Zyrën e Projekteve si edhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin në Senatin Akademik në zbatim të nenit 46 të Ligjit Nr.80/2015 e cila koordinon punën me problematikat e departamenteve dhe jep ndihmesën për aplikime në projekte shkencore.</p>	
<p>Rezultatet e projekteve ruhen në një database. Kjo zyrë në bashkëpunim me departamentin e inxhinierive mban të dhëna në lidhje me mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.</p>	
GVJ konkludon:	
<p>Standardi III.3 – mendojmë se përmbushet; Standardi III.4 – mendojmë se përmbushet Standardi III.10 – mendojmë se përmbushet Standardi III.11 – mendojmë se përmbushet</p>	

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bashkëpunimi me të gjithë grupet e interesit është në fokusin e Institucionit. Kjo shprehet qartë edhe në objektivat e paraqitura në strategjinë e zhvillimit të Univeritetit .Bashkëpunimi synon të rritet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Departamenti i Inxhinierive bashkërendon punën edhe me departamentet e tjera lidhur me këtë drejtim. Institucioni ka marrëveshje institucionale me 3 universitete, me të cilët Departamenti i Inxhinierive ka shkëmbim stafi në kuadër të mësimdhënies dhe bashkëpunon me 7 universitete për organizim konferenca dhe staf PAK.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit konsistojnë në përcaktimin e fushave kërkimore me qëllim integrimin ndërmjet strukturave për aktivitetin didaktiko-terik-praktik përmes organizimit të kurseve universitare dhe pasuniversitare; shkëmbimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore në projekte të kërkimit shencor me interes të përbashkët si: konferenca, trajnime etj.

Konstatojme një punë të madhe që bëhet në lidhje me bashkëpunimin me kompani të mëdha të biznesit në Shqipëri. Tashmë ky departament ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me 21 kompani ku mundësohet aftësimi profesional i studentëve përmes praktikave profesionale dhe marrjes së ofertave për punësim të tyre. Departamenti i Inxhinierive duhet të bëjë një punë më të madhe në lidhje me konsolidimin e bashkëpunimeve me kompanitë e biznesit. Nuk është e qartë impakti që këto bashkëpunime kanë sjellë në përmirësimin e kurrikulës. Sic theksohet edhe në studimin e tregut marrja e mendimit nga kompanitë e biznesit është e dobët dhe rekomandojmë Departamentin e Inxhinierive të punojë më shumë në drejtim të forcimit të lidhjeve me fushën e biznesit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ evidentoi se AU ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p> <p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale janë nënshkruar 21 marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë e biznesit, <i>ndonesë rekomandojmë një punë më të madhe nga ana e departamentit të inxhinierive në drejtim të konsolidimit të marrëdhënieve me to.</i></p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>AU garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave që përcaktohen edhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>AU për realizimin e objektivave të programit të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas.</p> <p>AU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Kjo dëshmohet me dokumentet e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e tij të diplomuar.</p> <p>Nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • AU ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas. • Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit dhe institucionet shtetërore dhe private në lidhje me praktikat profesionale është aktiv (në total bashkëpunon me 21 kompani private biznesi) por, <i>rekomandojmë një punë më të madhe nga ana e departamentit të inxhinierive në drejtim të konsolidimit të këtyre marrëdhënieve.</i> • AU bashkëpunon edhe me Universitet brenda vendit dhe në rajon duke rritur mundësinë e 	

mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik.

- Nuk ka raporte në lidhje me impaktin e bashkëpunimit me kompanitë e biznesit. Nuk është e qartë impakti që këto bashkëpunime kanë sjellë në përmirësimin e kurrikulës. Sic theksohet edhe në studimin e tregut marrja e mendimit nga kompanitë e biznesit është e dobët dhe rekomandojmë Departamentin e Inxhinierive të punojë më shumë në drejtim të forcimit të lidhjeve me fushën e biznesit.

GVJ konkludon:

Standardi V. 3 – mendojmë se përmbushet;

Standardi VII.1 – mendojmë se përmbushet;

Standardi VII.2 – mendojmë se përmbushet;

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike funksionon mbi një bazë të konsoliduar ligjore dhe institucionale. Në mbështetje të tij janë ngritur njësi kolegjiale dhe administrative të cilat mbështesin zhvillimin e tij.
- 2) Universiteti Privat "Albanian University" paraqet një stabilitet financiar dhe zbaton politika financiare investuese në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, personelit akademik dhe kërkimit shkencor.
- 3) Programi i studimit është subjekt përmirësimi periodik në përputhje me kërkesat e tregut të punës, të aktive ligjore e nënligjore në fuqi, mendimit të studentëve dhe reflektim i zhvillimeve të fundit në fushën e inxhinierisë elektronike;
- 4) Programi është hartuar bazuar në eksperiencat më të mira të universiteteve politeknike italiane dhe shqiptare.
- 5) Në këtë program studimi angazhohet një staf akademik me eksperiencë dhe me grada të duhura shkencore.
- 6) Disponimi i laboratorëve bashkëkohorë të përdorur në procesin mësimor;
- 7) Angazhim aktiv i studentëve në konferencat studentore.

b. Pika të dobëta:

- 1) Ndikimi negativ në cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e kërkimit shkencor i ngarkesës së lartë mësimore që mbulon stafi akademik efektiv në programet Bachelor dhe Master që mbulohen nga ~~Departamenti i Inxhinierive;~~
- 2) Marrëdhënie të paqëndrueshme me institucionet pranë të cilave zhvillohen praktikat mësimore.
- 3) Shkallë relativisht e ulët e përthithjes së mendimit të kompanive të biznesit në raport me zhvillimin e kurrikulës.

c. Mundësitë:

- 1) Rritja e bashkëpunimit me universitete brenda vendit dhe ato rajonale në shërbim të përmirësimit të cilësisë së formimit inxhinierik të studentëve dhe në drejtim të zhvillimit të një kërkimi shkencor cilësor;

- 2) Përmirësimi i metodave për mbledhjen e të dhënave nga Zyra e karrierës & alumni për studentët e punësuar pas përfundimit të programeve të studimit;
- 3) Përfitim i eksperiencës në drejtim të aplikimit në projekte dhe organizimit të aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- 4) Rritja e shkallës së mobilitetit të studentëve në kuadër të Programit European Erasmus+;
- 5) Pasurimi në vazhdimësi i bibliotekës me literature bashkëkohore.

d. Pengesat:

- 1) Vështirësitë për sigurimin e personelit akademik efektiv me kualifikimin e kërkuar;
- 2) Ndonëse institucioni ka ngritur njësitë për mbështetjen dhe zhvillimin e kërkimit shencor ka një mungese eksperience të stafit akademik në lidhje me aplikimet në projekte.
- 3) Institucionet pranë të cilave zhvillohen praktikat mësimore nuk janë në vazhdimësi të disponueshme për kryerjen e praktikave mësimore pranë tyre.

II. SUMMARY ANALYSIS FOR THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM MSc. IN "ELECTRONIC ENGINEERING" IN "ALBANIAN UNIVERSITY"

a. Strengths:

- 1) The study program Master of Science in Electronic Engineering is functioning on a consolidated institutional and legal basis. The Institution has established collegial and administrative units to support the development of the program.
- 2) The "Albanian University" presents a steady financial state and implements the investment policies in terms of improving infrastructure, academic staff and scientific research.
- 3) The study program is a subject of periodic improvement in compliance with labor trade demands, legal & sub-legal provisions in power, the options of students as well as the reflection of progress in the field of electronic engineering.
- 4) The study program is compiled in accordance with best experiences from polytechnical universities in Italy and Albania;
- 5) In this program are engaged an academic staff holding experience and appropriate scientific degrees.
- 6) Availability of modern laboratories used in the teaching process;
- 7) Active participation of students in Student's conference.

b. Weaknesses:

- 1) Negative impact on quality of teaching process and scientific research progress of academic staff as result of high teaching load provided in Bachelor & Master study programs offered by the Engineering Department;
- 2) Unsustainability cooperation with companies in which professional practices are held;
- 3) Embracing the business option toward curricula development is relatively low;

c. Opportunities:


- 1) Enhancement of cooperation with national and regional universities toward quality improvement of students knowledge and scientific researches development;
- 2) Improvement of data collection methods used by Career & Alumni Office for alumni students;
- 3) Experience gained in applying projects and organizing national and international scientific activities;
- 4) The increase of students mobility within the frame of the European Erasmus +Program;
- 5) Continuous enrichment of the library with contemporary literature;

d. Threats:

- 1) Difficulties in assuring effective academic staff with the required qualification;
- 2) Although the institution has set up units for support and development of scientific research there is a lack of academic staff experience with regard to project applications;
- 3) Institutions to which the teaching practices are developed are not continuously available for carrying out these practices;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Thoma KORINI
2. Dr. Alketa GREPCKA

Handwritten signature and initials in blue ink. The signature appears to be 'TK' inside a circle, with a horizontal line above it and some additional scribbles to the right.

ANEKSE

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Departamenti i Inxhinierive	23	(2) Prof. Asoc. Dr. (8) Dr. (2) Dr. Në proces; (11) MSc.	14	(1) Prof. Dr. (7) Prof.Asoc.Dr. (5) Dr.; (1) MSc.	37	(1) Prof.Dr. (9) Prof.Asoc. (13) Dr. (2) Dr. në proces (12) MSc.

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentin e Inxhinierive për vitin akadmeik 2017 – 2018 :

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Departamenti i Inxhinierive							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Viktor Topulli	Pedagog	Prof.Asoc.Dr.	1	Petraç Marango	Prof. Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Mareglen Bukli	Pedagog	Prof.Asoc.Dr.	2	Adhurim Hoxha	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
3	Genta Rexha	Pergjegjes departamenti	Dr.	3	Ariana Bejleri	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
4	Besjana Tosuni	Pedagog	Dr.	4	Enkela Noçka (Karroçi)	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
5	Leke Pepkolaj	Pedagog	Dr.	5	Agim Anxhaku	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"
6	Fatmir Basholli	Pedagog	Dr.	6	Igli Tafa	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
7	Miranda Harizaj	Pedagog	Dr.	7	Indrit Enesi	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
8	Giogio Mustafaraj	Pedagog	Dr.	8	Bexhet Kamo	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
9	Fatmir Brati	Pedagog	Dr.	9	Bledar Kurti	Dr.	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes AU

10	Klodian Kurti	Pedagog	Dr.	10	Alban Rakipi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
11	Eglantina Merkaj	Pedagog	Drnt.	11	Luçiana Toti	Dr.	Universiteti i Durrësit "Aleksander Xhuvani"
12	Armela Mazrreku	Pedagog	Drnt.	12	Romeo Teneqexhi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
13	Burhan Çanga	Pedagog	MSc.	13	Desar Shahu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
14	Katerrina Dhoska	Pedagog	MSc.	14	Albana Vrapit	MSc.	Ministria e Brendshme, Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit
15	Besmir Kanushi	Pedagog	MSc.				
16	Sidita Çoniku	Pedagog	MSc.				
17	Rodolf Zyka	Pedagog	MSc.				
18	Enis Çerri	Pedagog	MSc.				
19	Malvin Rrushi	Pedagog	MSc.				
20	Robert Kodra	Pedagog	MSc.				
21	Pranvera Hysenaj	Pedagog	MSc.				
22	Arber Vila	Pedagog	MSc.				
23	Arber Malaj	Pedagog	MSc.				

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Departamentin e Inxhinierive për programin e studimit MSc. Inxhinieri Elektronikë për vitin akadmeik 2017 – 2018:

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Departamenti i Inxhinierive							
Programi i studimit: Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronikë							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time		
1	Genta Rexha	Pergjegjes departamenti	Dr.	1	Bexhet Kamo	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Leke Pepkolaj	Pedagog	Dr.	2	Desar Shahu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
3	Fatmir Basholli	Pedagog	Dr.	3			
4	Miranda Harizaj	Pedagog	Dr.	4			
5	Klodian Kurti	Pedagog	Dr.	5			

Tabela 3: Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Genta Rexha	Dr.	Kryetar
Lekë Pepkolaj	Dr.	Anëtar
Indrit Enesi	Prof.Asoc.Dr.	Anëtar

Tabela 4: Staf i akademik i programit të studimit, per vitin 2017-2018

Titulli	Stafi akademik i programit të studimit: MSc. Inxhinieri Elektronike Viti akademik 2017 – 2018		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë			0/0
Profesorë të As.		1	0/1
Doktorë	5	1	5/1
PHD	0	0	5/1
Pedagogë në proces DR	0		0/0
Asistentë me MSc.	2		2/0
Personeli ndihmes akademik	9		9/0

Tabela 5: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit

Të ardhurat nga:	Viti 2017-208	Viti 2	Viti 3
Pushteti qendror			
Pushteti vendor			
Fonde jopublike:			
Grantet për kërkim dhe kontratat			
Konsulencat, shërbimet			
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	10,725,000		
Sponsorizimet			
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)			
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj			
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	10,000		
SHUMA	10,825,000		

Tabela 6: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Desara Agaj	Përgjegjëse	2 vite
2	MSc. Sidita Çonku	Specialiste	2.5 vite
3	Dr. Lekë Pepkolaj	Anëtar i grupit të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë	2 vite
4	Dr. Fatmir Basholli	Anëtar i grupit të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë	2 vite

Tabela 7: Planet mësimore të licensuara

Viti I Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavartur	Gjithsej							
				Leksione				Seminare			Ushtrime			Laborator					DK/PK			Praktikë			
				ECTS	Në auditor	P. e Pavartur	ECTS	Në auditor	P. e Pavartur	ECTS	Në auditor	P. e Pavartur	ECTS	Në auditor	P. e Pavartur				ECTS	Në auditor	P. e Pavartur	ECTS	Në auditor	P. e Pavartur	
1	I	5	4	3.5	37	50.5				1	15	10	0.5	8	4.5							60	65	125	
2	I	5	4	3.5	37	50.5				1	15	10	0.5	8	4.5							60	65	125	
3	I	5	4	3.5	37	50.5				1	15	10	0.5	8	4.5							60	65	125	
4	I	6	5	3.5	37	50.5				1.5	23	14.5	1	15	10							75	75	150	
5	I	4	4	3	30	45				2	30	20	0	0	0							60	65	125	
6	I	5	3	3	30	45				0.5	8	4.5	0.5	8	4.5							46	54	100	
7	II	5	3	3	30	45				0.5	8	4.5	0.5	8	4.5							48	77	125	
8	II	5	4	3.5	37	50.5				1	15	10	0.5	8	4.5							60	65	125	
9	II	6	4	3	30	45				2	30	20	0	0	0							60	65	125	

10	Teoria e radiofrekuencave 2	II	4	4.5	3.5	37	50.5	0.5	4	8.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5	65	85	150
11	Lëndë me zgjedhje (Gr. 1)	II	5	3	2.5	23	39.5				1	15	10	0.5	8	4.5			446	54	100	
12	Rrjeta telematike	II	5	4	3.5	37	50.5				1	15	10	0.5	8	4.5			60	65	125	
Totali			60	42	3	402	573	0.5	4	805	13.5	204	133.5	5.5	87	50.5	1.5	3	34.5	700	800	1500

Lende me zgjedhje:

Grupi 1

- Akustika e aplikuar dhe teknika e ndriçimit
- Filtra dhe rrjeta jolineare

Tabela 7: Planet mësimore të licensuara

Viti II Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej						
				Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator						DK/PK			Praktikë		
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur
1	Antena dhe shpërndarja e valëve në hapësirë	III	5	5	3	30	45				1.5	23	14.5	0.5	8	4.5			61	64	125			
2	Teori rrjetash e avancuar	III	5	4.5	33	30	45				1	15	10	1	15	10			60	65	125			
3	Sistemet me mikroprocesor	III	5	4	33.5	37	50.5				0.5	8	4.5	0.5	8	4.5	1	2	48	77	125			
4	Telekomunikacioni me fibra optike	III	5	5	3	30	45				1	15	10	0.5	8	4.5			60	65	125			
5	Lëndë me zgjedhje (Gr. 2)	III	5	3.5							0.5	8	4.5	0.5	8	4.5			46	54	100			
6	Praktika mësimore	IV	6																6	0	150	150		
7	Teza e diplomës	IV	30																100	650	750			

Totali	60	14	15.5	157	230.5		4.5	69	43.5	3	47	28	1	2	23	6	0	150	375	1125	1500
--------	----	----	------	-----	-------	--	-----	----	------	---	----	----	---	---	----	---	---	-----	-----	------	------

I Lëndët e semestrit të parë të vitit të dytë zhvillohen në 12 javë mësimore, praktika mësimore zhvillohet në 3 javët e fundit të semestrit të parë. Semestri i dytë i vitit të dytë i dedikohet diplomës

Lende me zgjedhje: Grupi 2

- Pajisjet biomedikale
- Rrjetat radiolëvizëse

Tabela 7/1: Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Viti I Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Leksione			Seminare			Ushtrime			Laborator			DK/PK			Praktikë			
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarrur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarrur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarrur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarrur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarrur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarrur	
1	I	5	3	3	30	45	0	0	0	0.5	8	4.5	0.5	8	4.5	1	2	23			48	77
2	I	6	5	3.5	37	50.5	0	0	0	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0			75	75
3	I	6	4.5	3.5	37	50.5	0.5	4	8.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5			65	85
4	I	5	4				0			1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0			60	65

PLANI MËSIMOR – Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Metoda numerike për zgjidhjen e ekuacioneve diferencialë të zakonshëm dhe me derivate të pjesshme, Përafrimi i ekuacioneve diferenciale me derivate të pjesshëm me diferenca të fundme	10	10
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Teoria e radiofrekuencave (1-2)	11	50
	Teoria e rrjetave, Rrjetat telematike	10	
	Mikroelektronika	4	
	Antenat dhe shpërndarja e valëve në hapësirë	5	
	Sensorët dhe instrumentim procesesh (1-2)	10	
	Teori rrjetash e avancuar	5	
	Telekomunikacioni me fibra optike	5	
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	Sistemet me mikroprocesor, Projektimi i qarqeve digjitale	10	10
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Lëndë me zgjedhje-Gr.1	4	8
	Lëndë me zgjedhje-Gr.2	4	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Algoritëm dhe programim i avancuar	6	12
	Praktika mësimore	6	
Teza e Diplomës (F)	Teza e diplomës	30	30

Tabela 8: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Viti akademik 2017 – 2018				
Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1. Teoria e radiofrekuencave 1	Bexhet Kamo	Prof. Asoc. Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAK
2. Sensorët dhe instrumentim procesesh -1	Genta Rexha	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
3. Teoria rrjetash	Miranda Harizaj	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
4. Algoritëm dhe programim i avancuar	Genta Rexha	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
5. Metoda numërike për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale të zakonshëm dhe me derivate të pjesshëm	Leke Pepkolaj	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
6. Mikroelektronika	Fatmir Basholli	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
7. Projektimi i qarqeve dixhitale	Fatmir Basholli	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
8. Sensorët dhe instrumentim procesesh 2	Genta Rexha	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE
9. Përafrimi i ekuacioneve diferenciale me derivate të pjesshëm me diferenca të	Lek Pepolaj	Dr.	Departamenti i Inxhinierëve	PAE

	fundme				
10	Teoria e radiofrekuencave -2	Bexhet Kamo	Prof. Asoc. Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAK
11.	Akustika e aplikuar dhe teknika e ndricimit (L.Z Gr.1)	Fatmir Basholli	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAE
12.	Rrjeta telematike	Miranda Harizaj	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAE
13.	Antena dhe shpërndarje e valëve në hapësirë	Desar Shahu	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAK
14.	Teori rrjetash e avancuar	Miranda Harizaj	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAE
15.	Sistemet me mikroprocesor	Fatmir Basholli	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAE
16.	Telekomunikacioni dhe fibrat optike	Fatmir Basholli	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAE
17.	Pajisjet biomedikale (L.Z Gr.2)	Lodian Kurti	Dr.	Departamenti i Inxhinierieve	PAE

Tabela 9: Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit

Programi i Studimit MSc. Inxhinieri Elektronike	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	559
Seminare	4
Ushtrime	273
Laboratore	134
Praktikë lëndore	5
Praktikë profesionale	0
Tema e diplomës	100
Në total	1075

Tabela 10: Format e kontrollit të njohurive

Lëndët me leksione/seminare/laboratorë/detyrë kursi

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5%
Dorëzimi i detyrave të kursit	5%
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10%
Provimi i ndërmjetën/ moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Lëndët me leksione/seminare

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	10%
Dorëzimi i detyrave të kursit	10%
Provimi i ndërmjetën/ moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Lëndët me leksione/seminare/laboratorë

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5%
Dorëzimi i detyrave	5%
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10%
Provimi i ndërmjetën/ moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Tabela 11: Të dhëna për regjistrimin studentëve

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Studentë të transferuar sipas viteve (b)		Studente transferuar Brezat (b)	te per	Totali: (a)+(b)
		Viti I	Viti II			
2017-2018	28	4	23	27		55

Tabela 12: Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njesisë

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	3
Për punime shkencore individuale të studentëve	1
Për punime shkencore në konferencën studentore	13
Për projekte mobiliteti në rang departamenti	3
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	-

Tabela 13: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	60
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	8
3.	Numri i projekteve të zbatuara	9
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit	3
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	17
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	36

7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	14
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	0

Tabela 14: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	5
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	6
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	1
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	3
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	10
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit/ prezantime	0
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	0

Tabela 15: Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Organizata:	Lloji i bashkëpunimit
Sëiss EP	Bashkëpunim në kuadër të <i>Engineering & Tech Entrepreneurship Center - AU</i>
Business & Innovation Center	Bashkëpunim me <i>Engineering & Tech Entrepreneurship Center - AU</i>
Kompani të huaja:	
NetCO	Evente, projekte, kurse në fushën e energjisë së rinovueshme
Universitete:	
Universiteti Politeknik i Tiranës	Shkëmbim stafi
Universiteti i Durrësit "Aleksandër Moisiu"	Shkëmbim stafi
Universiteti i Shkodrës "Luigi Gurakuqi"	Shkëmbim stafi
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Shkëmbim stafi, Evente, projekte
Kolegji "Pjetër Budi"	Projekte, shkëmbim stafi
Universiteti i Salernos	Erasmus+
Kolegji Universitar Qirjazi	Evente, projekte
Komuniteti i biznesit, tregu i punës:	
A. E. Distribution	Praktika mësimore
Computer Copy Center sh.p.k.	Praktika mësimore
Birra Tirana	Praktika mësimore
Xpert Systems sh.p.k.	Praktika mësimore
Engineering Group sh.p.k.	Praktika mësimore
IN2 - Albania	Praktika mësimore
Sinteza CO	Praktika mësimore
Universal Office	Praktika mësimore
Forschner Albania sh.p.k.	Praktika mësimore
Xhenlux sh.p.k.	Praktika mësimore
Dajti Express sh.p.k.	Praktika mësimore
ITES	Praktika mësimore
Bregu sh.a.	Praktika mësimore
ELAL COM	Praktika mësimore
Union Financiar Tiranë	Praktika mësimore
Information Business Systems	Praktika mësimore

Real Visualz	Praktika mēsimore
Autoservis Nipt L 52006046L	Praktika mēsimore
Autoservis Safet GORARI	Praktika mēsimore
Auto King	Praktika mēsimore
Bashkia Kuçovë	Praktika mēsimore